

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7848 E enjte 11 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

**Shqipëria ka përballur dje një nga Sngjarjet më të rënda të viteve të fundit. Nuk bëhet fjalë thjesht për vjedhjen e disa miliona eurove, shumta ekzakte ...**

Vijon në faqen 20

Nga BLENDI FEVZIU

**Përse Shqipërisë i është cenuar siguria kombëtare?**



Opinion i Ditës

**Sulmeve të ashpura të opozitës dhe Sshqetësimit të publikut për grabitjen spektakolare të dhjetë milionë eurove në aeroportin e Rinasit ministri i Brendshëm ...**

Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

**Lleshi, gjenerali i policisë së vdekur**



Kush ishte i arratisuri nga burgu grek

## Admir Murataj u vra nga policia, vëllai: Shokët e lanë në rrugë

I riu me origjinë nga Tropoja ishte në kërkim për të paktën 3 grabitjet e tjera të milionave

Nuk ka më dyshime, personi që u vra pardje pas grabitjes në Rinas është i shumëkërkuari Admir Murataj, truri i grupit edhe në tri grabitje të blindave që transportonin paratë e bankave të nivelit të dytë. Admir Murataj është personi i maskuar si tullac, ai duket në momentin kur grabitësit e armatosur i janë afruar avionit ku morën 10 milionë euro në 3-4 minuta ...

Në faqen 2

**PERPLASJA/ QEVERIA: PERGJEGJESIA, E KONCESIONARIT. TIA: PERGJEGJESI E POLICISE**

# "SHERR" PER FAJTORIN, ZHDUKEN 10 MLN EURO

Grabitja, Rama: Kinezët dështuan, marrim kontrollin e aeroportit. Meta: U cenua siguria kombëtare. Xhaçka: Rinasin e ruan ushtria. PD: Antikushtetuese



(Në foto) Pamje nga grabitja në Rinas

Në faqet 3-6

INTEGRIMI

**BE: Duhet dialog, në Bruksel po vijnë sinjale negative nga ju**

Në faqen 7

VENDIMI

**Zjarrfikësit, 50% shtesë mbi pagën për çdo orë pune jashtë orarit**

Në faqen 8

PREMIERA

**Erotikë dhe dramë, flet Yllka Mujo: "Salome" është një sfidë e vërtetë**

Në faqen 19

TAKIMI

**Grupi Këshillimor Financiar: Sistemi i qëndrueshëm, u zgjerua sektori bankar**

Në faqen 9

PERFITUESIT E KEMP-IT



**Publikohet lista, 300 personat që do të kryejnë testet mjekësore**

Në faqen 11

Pronarët duhet të tërheqin dokumentin në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive

## Hipoteka, 1100 personat që kanë gati tapitë e shtëpive

*Përfituesit e certifikatave në qarkun e Elbasanit*

Publikohet lista me 1100 pronarët që kanë gati certifikatat e pronësisë. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit, ku përfshihet Librazhdi, Gramshi, Peqini, Belshi, Cërriku dhe Përrrenjasi. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, publikon



listën me 1100 personat që kanë përfutur lejet e legalizimit dhe që duhet të shkojnë në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të aplikuar për certifikatë pronësie. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUZIONI...

Në faqet 12-13

## GRABITJA NE RINAS SKANDALI

Me origjinë nga Tropoja, u arratis në vitin 2013 nga burgu i Trikallas në Greqi

# Admir Murataj, kush ishte i dyshuari si "truri" i grabitjes së 10 milionë eurove

U vra në shkëmbim zjarri me forcat e policisë

Nuk ka më dyshime, personi që u vra për dje pas grabitjes në Rinas është i shumëkërkuari Admir Murataj, truri i grupit edhe në tri grabitje të blindave që transportonin paratë e bankave të nivelit të dytë. Admir Murataj është personi i maskuar si tullac, ai duket në momentin kur grabitësit e armatosur i janë afruar avionit ku morën 10 milionë euro në 3-4 minuta, ndërsa në avion ndodheshin 160 pasagjerë që prisnin të udhëtonin drejt Vjenës. Murataj është grabitësi i vrarë, me syze, por pa maskë të zezë në fytyrë, jelek të zi dhe pantallona të zeza. Murataj mbante në fytyrë një maskë silikon. Ai u fiksua nga kamerat anash avionit, pranë barkut, ku ndodheshin edhe paratë. Para tij ndodhet grabitësi tjetër, por me uniformë tjetër; ushtarake (uniformë operacionale) teksa me armën e ngritur kërcënon punonjësit. Të dy mbajnë në duar doreza. Po kështu, duken edhe bagazhet teksa futen në avion. Murataj u qëllua sapo grupi ka marrë paratë e janë larguar. Ata u përballën me FNSH-të dhe policinë kufitare të Rinasit në një rrugë dytësore, ku kanë shkëmbyer zjarr. Gjatë shkëmbimit të zjarrit ai ka humbur jetën. Admir Murataj në vitin 2013 u arratis nga burgu i Trikallas në Greqi, ndërsa kërkohet nga drejtësia e vendit fqinj për disa akuzat nga vrasje, grabitje, por edhe plagosje. Sipas dosjes greke, Murataj ka përdorur 15 emra të ndryshëm, ndërsa pas burgosjes, arriti që të arratiset. Grupi, "truri" i të cilit ishte Murataj akuzohet se ka kryer të paktën tri grabitje të bujshme bankash dhe në total mund të ketë grabitur 7 milionë euro. Episodi i parë i grabitjes daton më 3 dhjetor të vitit 2015, ku në segmentin Qafë-Kashar-Rinas u grabit me armë një blind që transportonte një shumë të konsiderueshme parash nga një bankë e nivelit të dytë. Mekanizmi i ngjarjes rezultoi të ketë qenë i tillë që, mjeteve të shoqërisë private të ruajtjes dhe sigurisë u është prerë rruga nga një automjet i llojit fuoristradë, i cili është futur nga kryqëzimi i rrugës së fshatit Domje-Laknas në rrugën kryesore, ku në atë moment po kalonin mjetet me sasinë e të hollave. Episodi i dytë ka ndodhur më 9 shkurt të vitit 2017, po në rrugën e Rinasit, ku grabitja është bërë në të njëjtën mënyrë. Ndërsa grabitja e tretë ka ndodhur më 13 shkurt në një bankë në afërsi të ish-Stationit të Trenit në Tiranë, ku u vodh një tjetër sasi e konsiderueshme parash.



Viktima Admir Murataj

### S'KA ME "CASH" ME AVION

Për "The Guardian", zëdhënësjë e kompanisë "Austrian Airlines" ka deklaruar se do të ndalohej transportimi i parave 'cash' nga Tirana drejt Vjenës për arsye sigurie. Tanja Gruber ka treguar për gazetën britanike se si ka ndodhur edhe grabitja. "Sapo ishte kryer imbakimi i pasagjerëve. Në asnjë moment nuk ka pasur rrezik për stafin dhe pasagjerët. Nisja e avionit u shty 3 orë për shkak të grabitjes", ka thënë ajo.



Grabitësit me armë gjatë momentit të vjedhjes së lekëve

### "Janë përdorur si vegla. 2 vite që s'e takoja"

## Vëllai i Admir Muratajt: Do t'i gjejmë shokët që e lanë në rrugë!

Pasi identifikoi në morg trupin e Admir Muratajt, bashkë me kumatën, në një prononcim për mediat, vëllai i Admir-it, Cen Murataj thotë se prej 2 vitesh nuk komunikonte me vëllain e tij. Ai nuk e pranon që Admiri të ketë qenë organizator i grabitjes në aeroportin e Rinasit, ndërsa thotë se ende nuk e ka të qartë se prej kujt u vra vëllai i tij, nga shokët, apo nga policia. I riu hedh dyshime dhe kërkon ndihmën e policisë për ta zbardhur vrasjen. "Ishte në kërkim vëllai, prej dy vitesh nuk kam komunikuar me të. Ne nuk e dimë kush e ka vrarë, nuk i njohim shokët, por do t'i shohim kush janë shokët, ata që e kanë lënë në rrugë. Ose do t'i gjejmë neve, ose do t'i gjejë policia". Sa për faktin që ai mund të ishte organizatori apo truri i bandës, vëllai nuk e pranon, por hedh dyshime: "Besoj që janë përdorur si vegla. Do ta gjejmë fillin më vonë. Si ka mundësi që organizatori ngelet i vrarë dhe të tjerët ikin?! Do ta gjejmë, do të shohim", - thotë ai.

**INTERVISTA E PLOTË**  
Trupin e Admir-it e identifikoi e shoqja, ishte ai?



Vëllai i Admir-it, Cen Murataj dhe bashkëshortja

Po, është e vërtetë. Keni ndonjë të dhënë për ngjarjen?  
Asnjë të dhënë, na vjen keq.  
Sa vite keni pa komunikuar për vëllain?  
Shumë vite kam, dy vite...  
Ju keni edhe një vëll tjetër të dënuar nga drejtësia për grabitje, Admiri ishte i dënuar?  
Mish për peshk, Admir Murataj dhe vëllai tjetër.

Janë të përdorur, besoj të jenë vegla...  
Vegla nga kush?  
Do ta gjejmë fillin më vonë, do vijë momenti ta gjejmë se si mund të jetë... Organizatori Admir Murataj ngelet i vdekur në vend të tjerët ikin?! Ai ngelet mes rrugës së madhe i vrarë, do shohim...  
Ndërkohë vëllai juaj ka qenë i dënuar edhe në Greqi, për çfarë?



### FURGONI I DJEGUR

Në orët e para të së mërkurës është gjendur edhe një furgon tjetër i djegur ndërmjet fshatit Tapizë dhe zonës së Niklës. Policia nuk jep të dhëna, pasi ajo mund të përdoret nga autorët për të devijuar hetimet dhe ndjekjen e tyre njëkohësisht. Çështja ka kaluar për kompetencë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

S'ka qenë i dënuar, ka qenë në hetim.  
Kur ka qenë hera e fundit që keni komunikuar me vëllain tuaj?  
Dy vite ka...  
Keni ju dyshime apo informacione nga kush mund të jetë përdorur vëllai juaj?  
Do ta gjejmë. Po nuk e gjeti policia, do ta gjejmë me mënyrat tona.  
Policia ka ushtruar kon-

### trolle në banesën tuaj?

Tani jo. Edhe në punë, edhe në shtëpi ka ushtruar kontrolle më herët, por tani s'e ka pasur të nevojshme që të ushtrrojë.  
A i njihni ju shokët e Admir Muratajt, me kë shoqërohej ai?  
Jo, por do t'i njohim, do të interesohemi. Do t'i shohim kush janë shokët, ata që e lënë në rrugë. Admiri organizator ka mbetur i vrarë... Shokët ose do t'i gjejë policia, ose do të interesohemi t'i gjejmë ne.

Po si do t'i gjeni?  
Do të na ndihmojë policia, do ta shohim sa organizator është Murataj. Ai ishte vegël.  
Vegël e kujt, se është hera e dytë që e thoni?  
Do ta shohim...  
Dyshoni se e kanë tradhtuar shokët e tij?  
Diçka duhet të jetë. Organizatori nuk vritet.  
Ju dyshimet i keni se është përdorur nga shokët?  
Nuk e di, por i përdorur është me 1 mijë për qind.  
Në polici ju informuan si u vra?  
Nuk kemi asgjë të saktë, thonë që e kanë hedhur shokët e vetë aty...





**G**rabitja e djeshme në Rinas, ku u morën nga një avion në nisje 10 milionë euro të destinuar për në Austri me sa duket është kambana e fundit e alarmit për sigurinë në aeroportin e vetëm kombëtar në Shqipëri. Pas dislokimit të Forcave të Armatosura, në perimetrin e jashtëm në aeroportin e Rinasit, Policia e Shtetit merr sigurinë në kontroll duke rritur prezencën. Për të dhënë këtë lajm, ka dalë para mediave Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, zëvendës ministri i Infrastruktura, Artan Shkreli dhe zëvendës ministri, Besfort Lamallari. "Nuk kemi gjetur bashkëpunimin e duhur nga kompania që është përgjegjëse për sigurinë e aeroportit 'Nënë Tereza'. Nisur nga kjo por edhe me urdhër të kryeministrit, shefi i komisaritit të policisë Rinas merr edhe përgjegjësinë e drejtimit, menaxhimit, kontrollit e

**Asnjë e re për grupin e grabitësve dhe paratë e zhdukura**

**Shteti merr nën kontroll sigurinë në Rinas, mister fati i 10 milionë eurove**



bashkëpunimit me kompaninë e sigurisë në aeroport për kthimin e sigurisë në aeroport. Do të kërkojmë çdo ditë rritjen e parametrevë të sigurisë. Për ta kthyer aeroportin "Nënë Tereza" në një aeroport të sigurt e

model. Ne do të bashkëpunojmë edhe me Forcat e Armatosura në perimetrin e jashtëm", deklaroi Veliu.

Nga ana tjetër, zvmministri i Brendshëm Llamallari e cilësoi grabitjen si humbjen më të vogël, ndërsa theksoi

se nuk pati humbje njerëzish. "Ne patëm një bisedë me drejtorin e TIA. Që ka të bëjë me rritjen e sigurisë në aeroportin e Rinasit. Do të ndryshojmë duke pasur parasysh ngjarjen që ka ndodhur. Në këtë moment sikurse tha drejtori i policisë masat e policisë do të rriten. Çështja e sigurisë është edhe problemi i ruajtjes së një figure të një aeroporti ndërkombëtar.

Policia e Shtetit nuk hezitoi të ballafaqohet me grabitësit, sepse ky grup grabitësish ishte i armatosur deri në dhembë. Ka qenë humbja më e vogël, një humbje monetare, nuk kemi patur humbje njerëzish, as nga FA as nga forcat e policisë." - u shpreh Llamallari.

Sandër Lleshaj: Përgjegjëse, kompania kineze. Koncesionari: Aeroporti i shqiptarëve, jo i kinezëve

**Qeveri-TIA, përplasje për "fajtorin"**

*Koncesionari: Në rast incidenti të armatosur, duhet të ndërhyjë policia*

**Q**everia shqiptare akuzoi në katër deklaratat të ndryshme kompaninë Tirana International Airport si përgjegjëse për thyerjen e sigurisë në aeroportin e Rinasit të martën, kur një numër i paidentifikuar grabitësish të armatosur hynë në pistë, morën nën kontroll për disa çaste avionin e linjës Tiranë-Vjenë me 150 pasagjerë në bord dhe arritën të largohen në drejtim të paditur bashkë me disa thasë të mbushura me para. Pas deklaratës së ministres së Infrastruktura Belinda Balluku, përgjegjëse për menaxhimin e aviacionit civil në Shqipëri, ku i hidhej faji kompanisë koncesionare, ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj shkoi më tutje duke thënë se fajin e ka "kompania kineze" ndërsa ministria e mbrojtjes Olta Xhaçka deklaroi se do të dërgojë Forcat e Armatosura për të garantuar sigurinë në aeroport.



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj



Brendshme e vlerësojmë si të pasaktë," thotë kompania.

"Bëjmë thirrje dhe lutemi për vëmendje të kuptojmë të gjithë, se forcat e policisë janë të pranishme në çdo cep të aeroportit si objekt i rëndësishëm së veçantë, si zonë kufitare dhe policia e ka detyrë ligjore, për të ruajtur rendin dhe jetën e qytetarëve në rast incidenti të armatosur", shkruhet në deklaratë.

Tirana Airport Partners është kompania që fitoi një kontratë koncesionare nga qeveria socialiste në vitin 2004 ndërsa qeveria PS-LSI në vitin 2016 e zgjati afatin e koncesionit me dy vjet. TIA akuzohet se nuk ka investuar mjaftueshëm për sistemet e sigurisë ndërsa ajo thotë se pas ngjarjes së vitit 2016, kur një bandë kriminale kreu një grabitje të ngjashme pasi depërtuan në pistën e avionëve, dhe grabitën një sasi parash.

TIA u ankuu, gjithashtu, për etiketimin e përsëritur të ministrave dhe kryeministrit si "kompani kineze", një term që mbart notë denigruese në Shqipëri.

"Aeroporti nuk është i kinezëve, është i gjithë shqiptarëve" thuhet në deklaratë./ Reporter.al

**KONCESIONI I AEROPORTIT**  
Koncesioni i Rinasit u fitua fillimisht nga një kompani gjermane, e cila ia shiti më pas një kompanie spanjolle, e cila ia shiti kompanisë "Real Fortress Private Limited" për 83 milionë euro në vitin 2016. Koncesioni përfundon në vitin 2027.

"Kompania kineze që bleu aeroportin nga e mëparshme, dështoi po njësoj në garantimin e sigurisë," deklaroi Rama.

Kompania nga ana e saj i konsideroi deklaratat "keqinformim".

"TIA kishte vendosur të respektoje hetimet nga autoritetet përkatëse dhe në respekt të këtyre hetimeve,

nuk u pronouca deri më tani"-shkroi kompania në një deklaratë për shtyp për të shpjeguar heshhtjen 24 orëshe prej saj.

"Por, pasi ndoqëm me shqetësim deklaratën zyrtare të Ministrisë së Brendshme, duket se etika e TIA-s ka shërbyer për herë të dytë për një keqinformim të publikut dhe fajësimin -si

skënar i përsëritur - për një akuzë të rëndë që nuk qëndron në shpatullat e një koncesionari të huaj, pa mënjënuar kërkesat e Kontratës së Koncesionit që TIA përmbush çdo ditë në lidhje me sigurinë aeroportuale," vijon më tej deklarata.

Qeveria dhe në veçanti, Policia e Shtetit po përballen me pikëpyetjen se si mundet

që një numër njerëzish të armatosur të arrijnë të depërtojnë në aeroport, një objekt i sigurisë së veçantë, duke rrezikuar jetën e pasagjerëve dhe ekuipazhit të një avioni.

Sipas qeverisë, fajin për këtë cenim të rëndë të sigurisë kombëtare, e ka kompania private që menaxhon aeroportin. Kompania thotë se, në fakt, çështje të tilla i takojnë policisë dhe jo një kompanie private.

"[Aeroporti] është pjesë e territorit të Shqipërisë dhe mbrohet me ligj nga Policia e Shtetit si çdo metër i këtij vendi. Ndaj deklaratën zyrtare të Ministrisë së

## GRABITJA SIGURIA

Policia Ushtarake dhe komandot instalohen në perimetrin e jashtëm të "Nënë Terezës"

# Rama: Kinezët dështuan, marrim kontrollin e sigurisë së aeroportit

"Shteti shqiptar s'do të pranojë asnjë justifikim nga kompania"

Institucionet shtetërore shqiptare të fushës së sigurisë dhe të transportit ia kanë lënë përgjegjësinë për grabitjen e së martës në aeroportin "Nënë Tereza" koncesionarit kinez që e ka në administrim dhe menaxhim. Fillimisht, deputetët socialistë dhe më pas vetë kryeministri Edi Rama në reagimin ndaj kësaj ngjarjeje të rëndë, ku fare lehtësisht grabitësit depërtuan në pistën e avionëve duke grabitur 10 milionë euro, kanë etiketuar direkt kompaninë kineze që bleu aeroportin nga gjermanët si të dështuar në menaxhimin e sigurisë së tij. "Kompania kineze që bleu aeroportin nga e mëparshmeja, dështoi po njësoj në garantimin e sigurisë", shkroi kryeministri Edi Rama nga jashtë shtetit në një status të tij në rrjetet sociale. Më tej, ai duke e konsideruar situatën të papranueshme, bëri të ditur se institucionet e shtetit shqiptar do marrin në dorë sigurinë totale të aeroportit, përfshi perimetrin e jashtëm, ashtu edhe atë të brendshëm. "Shteti shqiptar s'do të pranojë asnjë justifikim nga kompania dhe do të marrë kontrollin e perimetrit të jashtëm e të sigurisë së brendshme. Respekt për policinë që sulmohet veshëgjatësisht", - shkruan Rama.

### USHTRIA

Një nga forcat që do angazhohet në sigurinë e aeroportit të vetëm që ka vendi ynë dhe nëpërmjet të cilit kryhen të gjitha udhëtimet dhe fluturimet me jashtë shtetit do të jetë pikërisht ushtria. Lajmin e bëri të ditur vetë ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, nëpërmjet një deklaratë për mediat, ku bëri të ditur se Forcat e Armatosura janë vendosur në aeroportin "Nënë Tereza" në Rinas. Konkretisht, bëhet fjalë për efektive të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave tona të Armatosura. "Në kushtet e një papërgjegjshmërie të përsëritur të koncesionarit për të respektuar detyrimet e tij ligjore për garantimin e sigurisë së aeroportit, kam urdhëruar që në perimetrin e sigurisë së aeroportit "Nënë Tereza" të vendosen efektive të Policisë Ushtarake dhe Batalionit Special të Forcave tona të Armatosura", - deklaroi ministria e Mbrojtjes. Xhaçka tha se kjo është një praktikë që zbatohet sot në thuajse çdo kryeqytet europian, ku njësi të Forcave të Armatosura vendosen në mbështetje të kolegëve të tyre



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka

## Mazhoranca: Të rishikohet marrëveshja koncesionare me kinezët

Thuajse e gjithë mazhoranca nuk sheh asnjë përgjegjësi të sigurisë dhe rendi që ofrojnë sot institucionet shtetërore shqiptare të sigurisë, tekta faktore për ngjarjen e dy ditëve më parë në Rinas konsiderojnë kompaninë kineze koncesionare. Ndaj, sipas tyre, grabitja e 10 milionë eurove përveçse një ngjarje e rëndë kriminale dhe që dëshmoi dështimin e sigurisë së aeroportit që ka marrë përsipër koncesionari, nuk ka cenuar sigurinë kombëtare, megjithëse ngjarja u zhvillua brenda perimetrit të një objekti të një rëndësie të veçantë. "Siguria kombëtare është një fjalë e madhe", - u shpreh dje ish-ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli. Ndërkohë që kryetarja e Komisionit të Sigurisë, Ermonela Felaj pranoi se episode të tilla



prekin sigurinë kombëtare. "Janë momente që e vendosin në diskutim sigurinë kombëtare dhe krijojnë premisa të qarta për cenimin e saj", - tha Ermonela Felaj. "Ngjarja na shqetëson, por kjo nuk do të thotë se është cenuar siguria kombëtare", - tha deputeti Edmond Leka. Ndaj, ata kërkojnë që të rishikohet marrëveshja kon-

tionare e aeroportit. "Gjatë momentit që ndodh për shembull skanimi i mjeteve, aty nuk ka prani policie, pasi kontrata koncesionare e ndalon këtë. Shpresoj që shpejt në të kemi ndryshime të marrëveshjeve koncesionare, edhe pse ju e dini që nuk janë marrëveshjet më të thjeshta, kanë edhe penalitete", - u shpreh Felaj.

urdhëruar që edhe "Policia Ushtarake të dislokohehet në këtë komandë, duke ju bashkuar kështu Policisë së Shtetit për ta mbështetur atë në garantimin e sigurisë së aeroportit", shtoi ministria. Ashtu siç është edhe qëndrimi i mazhorancës ndaj kësaj ngjarjeje, edhe Xhaçka theksoi se përgjegjësia për atë që ka ndodhur është e konce-

tionarit. "Kjo është një shkelje e papërgjegjshme dhe shumë e rëndë e legjislacionit shqiptar, për të cilën shpresoj dhe besoj që përgjegjësitë penale të jenë konkrete. Kjo situatë kërkon një ndërhyrje urgjente, sepse në nuk mund të lejojmë të cenohet as siguria e qytetarëve dhe as imazhi i vendit", - shtoi Xhaçka.



Aeroporti "Nënë Tereza"

### DEKLARATA

## Koncesionari të mos merret me rripat e pantallonave

Deputeti socialist, anëtar i Komisionit të Sigurisë, Paulin Sterkaj, duke e konsideruar të dështuar menaxhimin e sigurisë së aeroportit nga ana e kompanisë kineze, deklaroi jo pa ironi se kompania më mirë të rruaj aeroportin nga kriminelët sesa u heq rripat e pantallonave pasagjerëve. "Do t'i kisha bërë thirrje koncesionarit që operon në aeroport, sa kontrollojnë çantat, na heqin edhe rripat nga brezi, më mirë të kenë parasysh të bëjnë sigurimin në Rinas për të mos u futur kriminelët", tha Sterkaj.



## Rama nderohet me medaljen e Komandantit të Urdhrit të Shën-Karlit

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje një vizitë zyrtare në Principatën e Monakos, me ftesë të Princit Alberti II. Kryeministri u prit në një ceremoni të veçantë zyrtare në Pallatin Mbretëror në Monako nga Princi Alberti II dhe kreu i qeverisë së Monakos, Serge Telle. Në takimin e zhvilluar, kryeministri Edi Rama dhe princi Alberti II vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm mes dy vendeve në fusha si ajo e mjedisit, turizmit, marinës etj. dhe theksuan angazhimin e tyre për ta thelluar më tej këtë bashkëpunim në të ardhmen. Gjatë kësaj vizite, princi dekoroi kryeministrin me medaljen e Komandantit të Urdhrit të Shën-Karlit të Principatës së Monakos. Urdhri i Shën-Karlit është dekorata më e lartë e Principatës së Monakos. Është themeluar nga paraardhësi i Albertit II, Princi Karl III, më 15 mars 1856. "Kryeministri i Shqipërisë u nderua me këtë urdhër gjatë vizitës së tij zyrtare në Principatën e Monakos më 10 prill 2019, jo për reciprocitet, por për merita të veçanta në forcimin e marrëdhënieve mes dy shteteve dhe angazhimin e tij në mbrojtjen dhe promovimin, si faktorë zhvillues për Mesdheun, të bregdetit dhe zonave detare. Gjithashtu, Princi Albert II vlerëson nëpërmjet kësaj dekorate kryeministrin si një personalitet të kulturës", - thuhet në njoftimin e Kryeministrisë.





Presidenti: Të gjenden autorët dhe paratë, gati të bashkëpunoj me prokurorinë

# Grabitja në aeroport, Meta: Cenim serioz i sigurisë kombëtare

"Mund të kishte pasoja tragjike për njerëzit"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, e konsideroi dje cenim të sigurisë kombëtare rastin e grabitjes së djeshme në aeroportin e Rinasit. Kreu i shtetit përmes një dalje të posaçme për mediat u kërkoi të gjitha agjencive ligjzbatuese angazhim maksimal për kapjen sa më parë të autorëve dhe hetimin e ngjarjes. Presidenti u bëri thirrje institucioneve të kryejnë hetime të thella, në mënyrë që ngjarja të zbardhet dhe të vihen para përgjegjësish personat që nuk kanë kryer detyrën. Meta kërkoi hetime intensive për kapjen e autorëve të grabitjes, por edhe gjetjen e vlerave monetare të marra. Presidenti gjithashtu kërkoi të nxirren dhe evidentohen përgjegjësit e plota për çdo institucion që nuk ka kryer detyrën sipas ligjit, për parandalimin e kësaj ngjarjeje të përsëritur, që mund të kishte pasur pasoja edhe më të rënda dhe qytetarëve tanë, por edhe atyre të huaj. Kreu i shtetit kërkoi nga prokuroria të hetojë jo vetëm grabitjen e së martës, por edhe për mosmarrjen e masave në përmesjen e detyrimit ligjor dhe rekomandimeve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe nxjerrjen para përgjegjësisë të çdo institucioni dhe individit të përgjegjshëm që nuk ka kryer detyrën. "Në këto kushte, si President i Republikës e konsideroj ngjarjen e përsëritur të grabitjes së djeshme brenda territorit të aeroportit 'Nënë Tereza' cenim serioz të sigurisë kombëtare, rendit publik dhe imazhit të vendit. U kërkoi agjencive ligjzbatuese të vazhdojnë me vendosmëri operacionet për identifikimin e plotë dhe kapjen e autorëve, si dhe gjetjen e vlerave monetare të grabitura. Të gjitha autoritetet përgjegjëse dhe institucionet ligjzbatuese të kryejnë hetime të thella dhe të shpejtë të kësaj ngjarjeje të rëndë dhe të përsëritur", tha z. Meta.

**DEKLARATA**

"U kërkoi të gjitha agjencive ligjzbatuese të vazhdojnë me vendosmëri dhe intensitet operacionet për identifikimin e plotë dhe kapjen e autorëve përgjegjës, si dhe për gjetjen e vlerave monetare të grabitura. Të gjitha autoritetet përgjegjëse dhe institucionet ligjzbatuese të kryejnë hetime të plota dhe të thella për zbardhjen e shpejtë të kësaj ngjarjeje të rëndë dhe të përsëritur", tha z. Meta.



**PD: Nuk presim që SHBA-të të përkrasin djegien e mandateve**

Zëvendësndihmës Aekretari amerikan i Shtetit, Palm Zier, solli në Tiranë disa mesazhe të qarta për krizën politike, duke mbështetur qeverinë "Rama" e duke dalë kundër aksionit të opozitës për djegien e mandateve. Ish-ministri i Jashtëm, Aldo Bumçi, i cili ishte pjesë e takimit me diplomatën amerikan shtoi për "Vizion Plus" si u prit ky qëndrim në PD, duke shpjeguar arsye të shtynë opozitën tek ky vendim radikal. "Absolutisht ne nuk presim që as z. Palmer dhe askush tjetër të përgëzojë opozitën për djegien e mandateve. Ne nuk e presim këtë dhe nuk ka për të ndodhur kurrë. Djegia e mandateve është akti ynë për të reaguar ndaj kësaj krize të rëndë ku është Shqipëria. Për sa kohë jemi në protestë ne, as dy muaj, një muaj e gjysmë, shiko sa shumë ka ndryshuar. Më krashon protestat e 'Jelekëverdhëve' në Francë me protestat e Tiranës, partnerët të shqetësuar, Ramën në panik dhe që nuk qeveris më, e vërteta sheshit", deklaroi z. Bumçi.

**Aldo Bumçi**

"Ne do të përgatitemi për zgjedhje, ne jemi forcë elektorale, por zgjedhje me Ramën nuk ka. Ne dëgjuam partnerët përpara dy vitesh dhe u futëm në zgjedhje me Ramën. Çfarë ndodhi më pas, siç kanë treguar hetimet e prokurorisë, vërtetojnë se zgjedhjet ishin në kontrollin e lekëve të drogës e kërcënimit të krimi".

**ZBARDHJA**

Ilir Meta kërkoi angazhim maksimal të autoriteteve për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe për të vënë përpara përgjegjësi jo vetëm autorët, por edhe personat përgjegjës për ruajtjen



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

**REAGIMI**

Presidenti Meta kërkoi hetime intensive për kapjen e autorëve të grabitjes, por edhe gjetjen e vlerave monetare të marra, ndërkohë që i dorëzon prokurorisë dosjen sekrete të Këshillit të Sigurisë. Meta u bëri thirrje institucioneve të kryejnë hetime të thella, në mënyrë që ngjarja të zbardhet dhe të vihen para përgjegjësish personat që nuk kanë kryer detyrën.

**Vasili: Shteti i është dorëzuar krimi**

**Grabitja në Rinas, LSI: Asnjë zyrtar i shtetit i ndaluar**

Ish-deputeti i LSI, Petrit Vasili, akuzoi dje se grabitja Le 10 milionë eurove në aeroportin e Rinas është provë e qartë se shteti i është dorëzuar krimi. Në një deklaratë për mediat, ai tha se ngjarja e rëndë i vendosi damkën Shqipërisë botë. "Reflektimi i shtetit mbas ngjarjeve të përsëritura, njëra më e rëndë se tjetra në aeroportin e Rinasit ka sjellë që të kishim një ngjarje më të rëndë se të tjera. Në vend të reflektimit, shteti ka zgjedhur dorëzimin e plotë të shtetit dhe interesave të tij krimi dhe kriminelëve. Qytetarët ndihen më të rrezikuar pikërisht në atë pjesë të vendit, që është aeroporti i vetëm i vendit ku parametrat e sigurisë duhet të ishin maksimale dhe të padiskutueshme. Ky shtet tregon se tregon se vendi është në dorë të Zotit, ose më saktë, në dorë të kriminelëve, por kurrsesi në dorë të shtetit", theksoi z. Vasili. Sipas tij, vendimi i kompanisë ajrore austriake është i paprecedentë. Vasili shtoi pyetjen se kush do të mbajë përgjegjësi për ngjarjen. "Nuk ka asnjë zyrtar të shtetit të ngarkuar me përgjegjësi nga ligji që të jetë përpara drejtësisë e të ndalohet. Asnjë shkarkim, pezullim, asnjë arrestim nga përgjegjësit e kësaj pune. Ka përgjegjësi Policia e Shtetit, Aviacioni Civil i Republikës, shërbimet informatike dhe askush nuk përgjegjet. Kush do përgjegjet? Kush e ka përgjegjësinë? Kjo qeveri ka vetëm një përgjigje, se 'kështu ndodh në të gjithë botën'. Kjo qeveri e ka dorëzuar shtetin të krimi. I vuri damkën Shqipërisë në opinionin e huaj. Si përherë, gjurmët e grabitësve humbasin. Çdo ditë që kjo qeveri qëndron në atë karrige, është ditë e zezë për shqiptarët", deklaroi z. Vasili.



e rendit dhe sigurisë. "Të nxirren dhe të evidentohen përgjegjësit e plota për çdo institucion që nuk ka kryer detyrën sipas ligjit për parandalimin e kësaj ngjarjeje të përsëritur, që mund të kishte pasur pasoja edhe më të rënda dhe të rrezikshme, me pasoja tragjike për jetën e qytetarëve tanë dhe të huaj. Prokuroria të hetojë jo vetëm grabitjen, por edhe për mosmarrjen e masave në përmesjen e detyrimit ligjor dhe rekomandimeve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe nxjerrjen para përgjegjësisë të çdo institucioni dhe individit që nuk ka kryer detyrën. Nga ky moment Institucioni i Presidentit të Republikës vendos në dispozicion të prokuror-

isë të gjithë dokumentacionin që disponon mbi zhvillimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të datës 16 maj 2018 dhe konkluzioneve të tij", theksoi z. Meta.

**DOSJA**

Presidenti kërkoi hetim për 'Rinasin', ndërkohë që i dorëzon prokurorisë dosjen sekrete të Këshillit të Sigurisë. "Nga ky moment - tha Meta - Institucioni i Presidentit të Republikës vendos në dispozicion të prokurorisë të gjithë dokumentacionin që disponon mbi zhvillimin e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të datës 16 maj 2018 dhe të gjitha konkluzioneve të tij". "Si kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në 16 maj të vitit 2018 kam organizuar mbledhjen e këtij këshilli me objekt gjendjen e sigurisë kombëtare. Pika e tretë e axhendës së këtij takimi ishte pikërisht raportimi për pikat strategjike portuale dhe aeroportuale të Republikës së Shqipërisë. Kam ngritur shqetësimin lidhur me mungesën e përgjegjësisë të qarta, që viheshin re mbi garantimin e sigurisë në aeroportin 'Nënë Tereza', mangësitë në akses dhe ndërhyrjen e Policisë së Shtetit në rastet rrezik. Kemi ngritur një sërë shqetësimesh për grabitjen. Kemi vënë re mangësitë në akses dhe koordinim për ndërhyrjen e Policisë së Shtetit në rast rreziku. Shqetësimet u mbështetën edhe nga përfaqësues të rëndësishëm. Në përfundim të mbledhjes së Këshillit, detyrat u janë përcjellë zyrtarisht anëtarëve të Sigurisë Kombëtare". Sipas Ilir Metës: "Në detyrat që janë ngarkuar është kërkuar ngritja e punës për trajtimin e gjithçkaje për grabitjen në Rinas".

## NGJARJA AKUZAT

Valentina Madani

Për kreun e PD-së, Lulzim Basha, dy ngjarjet e fundit, dhuna ndaj banorëve të Bregu i Lumit e më pas grabitja në Rinas, janë dëshmi e qartë se shteti ka rënë. Basha hodhi akuza të forta mbi policinë e shtetit, duke theksuar se ajo tashmë është në luftë kundër popullit e jo krimin. Në një konferencë për mediat për grabitjen në Rinas, Basha akuzoi se vendi është kthyer në bazë operacionale të krimin të organizuar për shkak të lidhjeve me qeverinë. Ai ftoi qytetarët të bashkohen në protestë në 13 prill për largimin e Ramës. "Çdokush e kupton fare mirë se në çfarë niveli është policia, se në çfarë niveli është katandisur rendi dhe siguria publike. Që nga protesta e 16 shkurtit janë shoqëruar 114 qytetarë dhe janë arrestuar 52. Policia po përdoret për vetëm një qëllim: luftën kundër popullit, luftën kundër njerëzve të pafajshëm që mbrojnë shtëpitë e tyre. Në këto dy muaj është përdorur gaz helmues më shumë se në të gjithë historinë e Shqipërisë. Ndërkohë nuk ka asnjë përpjekje për të luftuar krimin. Vrasjet, tritolit dhe grabitjet me armë në mes të ditës po tronditin çdo ditë sigurinë në mes të qyteteve dhe rrugëve tona. I vetmi aktivitet kundër krimin është: policia shkohi në vendin e ngjarjes. Kur në Rinas, që është zona me sigurinë më të lartë në vend, kryhet grabitje me armë e avionit të linjës ndërkombëtare në mes të ditës", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së akuzoi se Shqipëria është kthyer në bazë operacionale e krimin të organizuar. "Kjo ndodh kur Shqipëria është bërë qendër e krimin ndërkombëtar, sipas raportit të DASH, bazë operacionesh e rrjeteve kriminale ku jo vetëm nuk luftohet, por po nxitet pastrimi i parave të krimin nga vetë qeveria me ndërtime dhe projektet korruptive në ndërtime, inceneratorë, turizëm dhe PPP", u shpreh z.Basha. Kreu i opozitës, në daljen për mediat tha se arsyeja dhe shkak kryesor i rënies së shtetit, i mungesës së sigurisë për jetën dhe pronën e qytetarëve është pakti mes krimin dhe qeverisë që ai e quan ilegjitime dhe ftoi qytetarët në protestën e 13 prillit. "Dhënia fund e këtij regjimi është sot emergjence kombëtare. Prandaj protestojmë të shtunën me 13 prill në Tiranë. Rruga e vetme për zgjidhjen e kësaj emergjence kombëtare, për kthimin e shtetit si garantues të ligjit, rendit dhe sigurisë publike është bashkimi i të gjithë shqiptarëve në betejën kundër padrejtësisë, krimin dhe korupsionit, për sigurinë, jetën dhe mirëqenien e çdo shqiptari", u shpreh Lulzim Basha.

Kreu i PD: Shteti ka rënë, policia po përdoret në luftë kundër popullit dhe jo krimin

# Ushtria mbron aeroportin, Basha: Dislokimi i FA-ve, antikushtetues

"Grabitja në Rinas, qeveria ilegjitime, pakt me krimin"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

### PËRPLASJA

"Nga përplasja mes banorëve në mbrojtje të shtëpive të tyre, 3 qytetarë përfunduan në spital ndërmjet të cilëve një 76-vjeçar me çarje në kokë që u operua, një grua me thyerje këmbë dhe një tjetër grua me frakturë. 10 qytetarë u shoqëruan në polici, të gjitha gra dhe 4 prej të cilave minorene dhe një fëmijë 5 vjeç. Që nga protesta e 16 shkurtit janë shoqëruar 114 protestues dhe janë arrestuar 52", tha z.Basha.

### SIGURIA

"I vetmi aktivitet kundër krimin është: policia shkohi në vendin e ngjarjes. Kur në Rinas, që është zona me sigurinë më të lartë në vend kryhet grabitje me armë e avionit të linjës ndërkombëtare në mes të ditës, çdokush e kupton se në çfarë niveli është policia, se në çfarë niveli është katandisur rendi dhe siguria", - u shpreh kreu i PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, në Durrës

padrejtësi dhe pasiguri në çdo cep të saj. Të gjithë ata që urdhëruan, dhunuan dhe sulmuan me gaz në shtëpitë e veta qytetarët dhe fëmijët e tyre në mënyrë kriminale, do të mbajnë përgjegjësi! Ju bëj thirrje të gjithë shqiptarëve ti dëgjojnë këto kambana alarmi, të bashkohemi, t'i japim dorën njerëzve për t'i dhënë fund këtij regjimi, e për të garantuar një qeveri që punon për popullin. #ShqipëriaSiEuropa", - u shpreh z.Basha.

### MESAZHET

Në Durrës dhe Elbasan, lideri i opozitës Lulzim Basha çoi mesazhin e rritjes së Partisë Demokratike si shumica e re qeverisëse e vendit. Nga qyteti bregdetar z.Basha premtoi se çdo politikan që ka abuzuar me pushtetin do të japë llogari para drejtësisë. "Do të japin llogari dhe nuk do të gëzojnë asnjë qindarkë që u kanë vjedhur durrsakëve dhe që kanë vënë mbi gjakun, djersën dhe pronat e durrsakëve. Vangjush Dakon e pret burgu. Edhe kryetarin e ri të shtabit elektoral të Partisë Socialiste, Damian Gjokunurin, burgu e pret edhe atë. Gjatë takimit me strukturat e PD-së z. Basha bëri thirrje për pjesëmarrje masive në protestën e 13 prillit për të ndryshuar situatën politike në vend. "Sot Partia Demokratike dhe opozita janë shumica e re qeverisëse e vendit. Ne kemi legjitimitetin moral, legjitimitetin politik për t'u përgjigjur kësaj klite kriminelësh. Këta nuk janë më shteti, këta janë antishqiptari", - u shpreh kreu i PD-së. Në 13 prill opozita do të zhvillojë protestën e 3 kombëtare para kryeministrit për të kërkuar largimin e Edi Ramës e krijimin e një qeverie teknike. Ndaj kreu i opozitës zhvilloi disa takime me banorët e Durrësit dhe të Elbasanit, ku i ftoi t'i bashkohen protestës së 13 Prillit.

## Kryemadhi: Fermerët po hedhin prodhimin, qeveria prioritet koncesionet

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste Për Integrimin Monika Kryemadhi ishte dje në Leshnicë të Progradecit nga ku akuzoi qeverinë se ka lënë pas dore fermerët dhe ka fokusuar të gjithë vëmendjen tek koncesionet. Sipas Kryemadhit, LSI i ka prioritet fermerët dhe në momentin që do të vijë në pushtet atyre do u kushtohet një vëmendje e veçantë. Në një postim të bërë në Facebook, ajo shkruan se nuk ka pasur "asnjë interesim nga qeveria për t'i kthyer në vlerë materiale mundin dhe djersën e njerëzve punëtorë dhe atdhedashës së Leshnicës. Kryeministri i



përsëritet me pamje nga Monako, ndërsa banorët e këtij fshati duan që prodhimet e tyre të mos kalben

### AKUZA

Kryemadhi akuzon qeverinë se ka lënë pas dore fermerët dhe e ka fokusuar të gjithë vëmendjen tek koncesionet. Sipas saj, LSI i ka prioritet fermerët dhe në momentin që do të vijë në pushtet, atyre do u kushtohet një vëmendje e veçantë.

dhe t'i hedhin në kanale". "Asnjë interesim nga qeveria për t'i kthyer në vlerë materiale mundin dhe

djersën e njerëzve punëtorë dhe atdhedashës së Leshnicës. Kryeministri i përsëritet me pamje nga Monako, ndërsa banorët e këtij fshati duan që prodhimet e tyre të mos kalben dhe t'i hedhin në kanale. LSI i ka prioritet fermerët shqiptarë. Ata japin 22% të prodhimit bruto të vendit dhe sot nuk marrin pas as 0.7% të buxhetit të shtetit. Qeveria e Rilindjes prioritet ka PPP dhe oligarkët. Me shumë paguhen ata për punë të pa kryer, se sa ka subvencionime për njerëzit e punës dhe sakrificës", - shprehet zj.Kryemadhi.

### USHTRIA

Kreu i PD, Lulzim Basha, reagoi dje nga Vlora lidhur me deklaratën e ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka, se do të ruajë aeroportin e Rinast me ushtri. Sipas tij, dislokimi i Forcave Ushhtarake është antikushtetues dhe një provë e rënies së shtetit dhe kapitullimit të Policisë së Shtetit. Basha shprehet se parakusht për largimin e krimin nga vendi është largimi i atij që e solli krimin në qeveri. Rama do ta sjellë vendin në kushtet e një grushti të vërtetë shteti, ndërsa thekson se përgjegjësi i vetëm për ngjarjen e ndodhur, sipas tij është kryeministri. "Në fund të një takimi plot

energji në Vlorë, dua t'u kujtoj shqiptarëve se njeriu që solli krimin në qeveri e parlament dhe për të mbrojtur aferat e tij me krimin shkatërroi drejtësinë dhe policinë shqiptare, është përgjegjësi kryesor për ngjarjen më të rëndë të sigurisë kombëtare, që në mënyrë të përsëritur ndodhi në Rinas. Ndaj dislokimi i Forcave Ushhtarake në mënyrë të antikushtetuese të jashtëligjshme është një provë e rënies së shtetit dhe kapitullimit të policisë së Shtetit. Asnjë alibi dhe fshehtë pas aferave të dështuara korruptive mes Edi Ramës dhe kompanisë koncesionare nuk do të mbulojë

përgjegjësinë e drejtëpërdrejtë të tij. Tani do ta sjellë vendin në kushtet e një grushti të vërtetë shteti për të dislokuar trupat tani që policia ka dështuar të kontrollojë sigurinë e rendin. Ndaj, rruga e vetme për të rikthyer sigurinë jo vetëm në Rinas, por kudo nuk është largimi i koncesionarit e policisë, por largimi i shkatërrit të kësaj ngjarjeje, Edi Ramës dhe bandës së tij në pushtet", tha z.Basha.

### HETIMI

Kreu i PD-së, Lulzim Basha bëri dje thirrje të fortë për shqiptarët që të bashkohen për t'i dhënë regjimit të lidhur me krimin, për të çliruar drejtësinë, e për të





Fleckenstein u shpreh se Kuvendi aktual mund ta miratojë reformën zgjedhore

# Situata politike, BE: Dialog, në Bruksel po vijnë sinjale negative

Gjoshja: Këshilli është viktima e radhës e një pushteti shfarosës

Situata politike në të cilën ndodhet vendi prej afro dy muajsh po ndikon negativisht sa i përket procesit të integritetit dhe përgjigjes pozitive që pret Shqipëria në qershor për hapjen e negociatave. Eurodeputeti Knut Fleckenstein mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritetit, ku mungonte opozita, ndërsa në fjalën e tij nuk la pa komentuar as zhvillimet politike në vend, duke theksuar nevojën për dialog. Ai u shpreh i lumtur që edhe qëndrimi i SHBA-ve është në të njëjtën linjë me atë të Bashkimit Europian sa u përket shkaqeve të krizës politike dhe mënyrës së daljes prej saj. Për këtë, ai iu referua qëndrimit të mbajtur nga Zëvendësdihmës Sekretari i Shtetit, Matthew Palmer, i cili vizitoi Tiranën dy ditë

më parë. "Jam i lumtur që edhe Zëvendësdihmës Sekretari i SHBA, Palmer, ka të njëjtin mendim si neve në Bashkimin Europian", tha eurodeputeti Fleckenstein. Ai foli për sinjale negative që po

përhapen në Europë për Shqipërinë pas krizës politike që ka përfshirë vendin. Ndaj, ai theksoi se PE i ka dyert e hapura për qeverinë dhe PD-në për trajtimin e çdo çështjeje". "Jam i lumtur që ky

këshill po vazhdon punën, neve na duhen sinjale pozitive, pasi në Europë tani po dëgjojmë disa sinjale negative dhe është e rëndësishme t'i shohim gjërat nga një këndvështrim tjetër. Ajo çfarë jemi dakord si Parlament Europian është që dyert tona janë të hapura si për parlamentin, si për PD-në. Unë jam optimist, një optimist i kujdesshëm, për sa i përket ecurisë", - ka thënë Fleckenstein. Siç shihet, edhe në deklaratën e tij, ai u tregua i kujdesshëm që në deklaratën e tij të mos përfshijë LSI-në. Kujtojmë se pak javë më parë mes tij dhe LSI-së pati një shkëmbim të ndërjellë deklaratash dhe akuzash të forta. Dy nga gjërat që mund të ndikojnë pozitivisht të çështja e hapjes së negociatave sipas eurodeputetit janë ngritja e SPAK dhe Gjykatës Kushtetuese. "SPAK shumë shpejt do të formohet dhe ministria e Drejtësisë më ka thënë se do të jetë kuorumi për ngritjen e Gjykatës Kushtetuese. Këto janë lajme shumë të mira, që do të ndikojnë në vendimin e qershorit. Unë e kam shprehur opinionin tim se çfarë po ndodh aktualisht në parlament dhe nuk dua ta përsëris", - tha ai.



Këshilli Kombëtar i Integritetit

**SPAK**

"SPAK shumë shpejt do të formohet dhe ministria e Drejtësisë më ka thënë se do të jetë kuorumi për ngritjen e Gjykatës Kushtetuese. Këto janë lajme shumë të mira, që do të ndikojnë në vendimin e qershorit. Unë e kam shprehur opinionin tim se çfarë po ndodh aktualisht në parlament dhe nuk dua ta përsëris", - tha ai.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk


Njofton se duke filluar nga data 09 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (AMBER LABEL)	320 Lekë/paketë
2	HEETS (BRONZE LABEL)	320 Lekë/paketë
3	HEETS (TURQUOISE LABEL)	320 Lekë/paketë
4	HEETS (YELLOW LABEL)	320 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar'" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670



## Propozimi, Gentiana Sula: Kandidatët për deputetë dhe kryebashkiakë, jo ish-sigurimsa

Kandidatët për deputetë dhe ata për kryetarë të bashkive apo këshillave bashkiakë duhet të kalojnë kontrollin e figurës, nëse kanë qenë bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ka propozuar Kuvendit që në Kodin Zgjedhor të jetë e sanksionuar që të gjithë të zgjedhurit, si në pushtetin vendor, edhe në atë legjislativ, të kalojnë në filtrat e këtij Autoriteti, pra të dëshmojnë se nuk kanë qenë pjesë e strukturave të Sigurimit në kohën e komunizmit. Propozimet i bëri kryetarja e këtij Autoriteti, Gentiana Sula, në Komisionin e Ligjeve gjat raportimit vjetor. Aktualisht ky kriter është vendosur vetëm për përfaqësuesit e organeve të reja të drejtësisë. "Nuk do të mjaftojë një ligj i yni i së drejtës për informim që të trajtohet dekomunistizimin, apo të trajtohet përballja me të shkuarën ashtu siç duhet. Për këtë arsye kemi marrë vendime për të parë se ku mund të ndërhyhet në legjislacione të ndryshme, për të mundësuar zbatimin e ligjit tonë dhe për ta harmonizuar atë me ligje të tjera", - tha Gentiana Sula. Ajo u shpreh se studiuesit dhe gazetarët kanë në dispozicion të gjitha informacionet e kërkuara, por 70 për qind e dosjeve të institucionit mbeten ende sekrete. "Natyra e dokumenteve është e tillë, shpeshherë përbaltëse dhe shpeshherë nuk është kollaj i verifikueshëm dhe duhet dëgjuar dhe zëri i personit të prekur", - shtoi Sula.

**REFORMA**

Fleckenstein nënvizoi gjithashtu se pavarësisht gjendjes politike, Kuvendi në gjendjen aktuale mund ta miratojë reformën zgjedhore, duke lënë në kuqetohet se nuk është domosdoshmëri miratimi i tij me konsensusin e të gjitha palëve. "Ju e dini mirë se si të gjeni një zgjedhje më të mirë dhe reforma elektorale mund të bëhet edhe në këto kushte ku jemi sot. Për këtë arsye uroj të kemi një diskutim sa më të mirë dhe sa më të dobishëm. Ne mund t'ju ndihmojmë dhe do t'ju mbështesim të eci përpara sa më shpejt", deklaroi Fleckenstein.

**GJOSHJA**

Ndërkohë, ish-ministria e Integritetit, Klajda Gjoshja e ka cilësuar mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritetit si një "show të ministrave që vijnë dhe ikin". Në një reagim pak minuta pas përfundimit të mbledhjes, Gjoshja tha se kjo instancë është larguar nga qëllimi kryesor për të cilin është ngritur. Sipas saj, në mbledhjen e sotme, në vend që të jepeshin sugjerime apo mbi iniciativa konkrete të qeverisë mbi procesin e integritetit europian, thjesht u raportua për pagat e institucionit të vetingut dhe investimeve në godina.

Vendimi i qeverisë/ 50% për çdo orë pune në ndërhyrje operationale të kryer natën

# Zjarrfikësit, shtesë 50% mbi pagën për çdo orë pune jashtë orarit

## Pagesat dhe pushimet, për çdo gradë dhe orë shërbimi

**K**oha normale e shërbimit për punonjësin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me gradë është 40 orë në javë. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji konsiderohet mesatarisht me 174 orë pune. 25% shtesë për çdo orë shërbimi në ditë të zakonshme pune dhe 50% për çdo orë shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor. Këto janë ndryshimet në oraret e punës dhe pagesat për punonjësit në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Rritja e pagesës për orët shtesë është miratuar dhe në mbledhjen e qeverisë dhe parashikohet që koha normale e punës/shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me gradë (në vijim shërbimi i MZSH-së) është 40 orë në javë.

**PAGESAT**

Sipas vendimit të qeverisë, për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji konsiderohet mesatarisht me 174 orë pune. Në pikën 3 të vendimit përcaktohet se shërbimi i gatishmërisë për punonjësin operacional të shërbimit të MZSH-së, si rregull organizohet sipas një planifikimi mujor, me turne 24-orëshe ose 12-orëshe, pa ndërprerje. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për orët shtesë të punës/shërbimit, që nuk janë kompensuar me pushim përfiton një shtesë mbi pagë në masën 25% për çdo orë pune/shërbimi shtesë në ditë të zakonshme pune, 50% për çdo orë pune/shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor, 25% për çdo orë pune në ditë të festave zyrtare dhe 50% për çdo orë pune në ndërhyrje operationale të kryer nga ora 22:00 deri në orën 06:00.

**AFATI I PAGESËS**

Për nevoja pune/shërbimi, me urdhër të titullarit të strukturës vendore të shërbimit të MZSH-së, pas kërkesës së drejtuesit të strukturës përkatëse, punonjësit të shërbimit të MZSH-së mund t'i ndërpriten koha e pushimit ditor/vjetor, duke urdhëruar zgjatjen e kohës së punës/shërbimit. Në rrethana të jashtëzakonshme, titullari i strukturës përkatëse mund të urdhërojë zgjatjen e kohës së punës/shërbimit, pas konfirmimit nga kryetari i bashkisë. Urdhri për zgjatjen e kohës së punës/shërbimit mbi kohën normale përcakton arsyen e zgjatjes së orëve të punës/shërbimit, kohën e fillimit dhe të përfundimit, numrin e punonjësve, koston financiare. Paga për orët jashtë orarit që i shtohet pagës mujore paguhet vetëm kur është parashikuar për këtë qëllim, brenda 3 muajve, nga dita kur është kryer shërbimi.



**PUSHIMET**

Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara: a) 40 ditë kalendarike për punonjësit me gradë "Drejtues i parë

zjarrfikës", "Drejtues i lartë zjarrfikës", b) 35 ditë kalendarike për punonjësit me gradën "Drejtues zjarrfikës", "Komisar Zjarrfikës", c) 30 ditë kalendarike për punonjësit me gradën "Kryeinspe-

ktor zjarrfikës", "Inspektor Zjarrfikës", c) 28 ditë kalendarike për punonjësit me gradë "Kryezjarrfikës", "Zjarrfikës", "Asistent Zjarrfikës". Planifikimi dhe koha e kryerjes së pushimeve vjetore

miratohet nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së shërbimit të MZSH-së pranë kësaj ministrie dhe nga kryetari i bashkisë përkatëse, për punonjësit e shërbimit vendor të MZSH-së,

pas konsultimit me punonjësin, pa cenuar vijueshmërinë e punës, brenda muajit shkurt të çdo viti. Ndërkohë, shkëputja e marrëdhënieve financiare për punonjësin, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës me strukturat e shërbimit të MZSH-së bëhet pas përfundimit të pushimeve vjetore të kryera. Në rastin kur punonjësi nuk ka kryer një vit të plotë kalendarik pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës së kryer brenda vitit kalendarik. Lejet e pagueshme dhe pa të drejtë marrin punonjësit të shërbimit të MZSH-së: martesën e tij, 5 ditë; martesën e fëmijës, 3 ditë; lindjen e fëmijës, për baballarët, 3 ditë; vdekjen e familjarëve të afërt, 5 ditë; ndërrimin e banesës, 2 ditë dhe sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve, 5 ditë.

**PAGESAT PËR ORËT SHITESË**

- Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për orët shtesë të punës/shërbimit, që nuk janë kompensuar me pushim përfiton një shtesë mbi pagë në masën:
  - a) 25% për çdo orë pune/shërbimi shtesë në ditë të zakonshme pune.
  - b) 50% për çdo orë pune/shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor.
  - c) 25% për çdo orë pune në ditë të festave zyrtare.
  - ç) 50% për çdo orë pune në ndërhyrje operationale të kryer nga ora 22:00 deri në orën 06:00.



**Transporti, probleme me Task-Forcën**

**Shoqata: Po gjobiten për stacionet e ndërmjetme**

**T**ask-Forca e transportit po na gjobit për shkak të ndalesave në stacione të ndërmjetme të linjave interurbane, të cilat de facto funksionojnë prej vitesh, por mungon një udhëzim i ministrit për përcaktimin ligjor të tyre". Deklarata vjen nga përfaqësuesit e Shoqatës Kombëtare të Transportit Ndërqytetës së Udhëtarëve, të cilët kërkojnë përcaktimin në licencë të këtyre stacioneve, duke u kursyer kohë dhe para udhëtarëve si dhe do të shmanget penalizimet për ta, që variojnë nga 25-100 mijë lekë e deri në heqje licençe. Sipas përfaqësuesve të shoqatës, puna e Task-Forcës duhet të fokusohet fillimisht te transporti i paligjshëm i udhëtarëve. Pak kohë më parë, ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, njoftoi ngritjen e një grupi pune për rishikimin e të gjitha problematikave që ka transporti ndërqytetës i udhëtarëve, ndërkohë që Shoqata Kombëtare kërkon që të bëhet pjesë e diskutimeve, si përfaqësuese e linjave në të gjithë vendin.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.05.2019. CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



**Njoftimi për biznesin**

**Tatimet: Si të korrigjoni deklaratat tatimore**

**D**rejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sjell në vëmendje të të gjithë tatimpaguesve të drejtën për të ndryshuar deklaratat tatimore, e drejtë kjo e sanksionuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Për deklaratat tatimore të dorëzuara me gabime, mangësi apo pasaktësi në llogaritje, tatimpaguesit i lind e drejta për t'i korrigjuar këto deklaratat tatimore brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare, sa herë konstaton gabime dhe pasaktësi në deklarim. "Ju sjellim në vëmendje se tatimpaguesi e humbet të drejtën për të korrigjuar deklaratat e tij në ulje detyrimi, nëse deklarata që ai kërkon të korrigjojë është kontrolluar nga administrata tatimore. Tatimpaguesi mund të ndryshojë një deklaratë të kontrolluar më parë, vetëm nëse ai ka për të deklaruar një detyrim tatimor më të madh se detyrimi që ka rezultuar nga kontrolli", - thuhet në njoftimin e Tatimeve.

Nga ana e Shoqërisë "Shërbimi Permbarrimore AB" Shpk është shpallur ankandi faza e parë për pasuritë e mëposhme:


1-"Triasti-Vokëtesë" me sipërfaqe truall 1328 m2 (njo mje e itroqind e njezet e tetëdhjetë) sipërfaqe ndërtesore 508 m2 (pesëqind e tele) me Nr.Pasurie 691/31 ne Zonën Kadastrale 1167, Volumi 8, Faqe 94 me adrese Komuna Berishtë, Tiranë.

Çmimi fillestar për shitjen ne ankand te pasurise eshte 881,600 (te tetëqind e tetëdhjetë e një mijë gjashtëqind) Euro.

2-"Triasti-Vokëtesë" me sipërfaqe truall 3761 m2 (tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) dhe sipërfaqe ndërtesore 1818 m2 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) me Nr.Pasurie 691/30 ne Zonën Kadastrale 1167, Volumi 8, Faqe 93 me adrese Komuna Berishtë, Tiranë.

Çmimi fillestar për shitjen ne ankand te pasurise eshte 1,280,000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) Euro

Ankandi do te zhvillohet ne date 23.04.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqërisë "Shërbimi Permbarrimore AB" Shpk me Permbarrues Gjyqësor Privat Admir Boqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.Teknoprojekti Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane



**Hiqet komisioni/ Nga 15 prilli 2019, licencat e taksive me vetëdeklarim**

**A**utomjetet e licencuara për transport udhëtarësh e taksitë, nga 15 prilli do të përfutojnë lehtësimin procedurash. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton se pas pak ditësh do të aplikohet procedura e re, që thjeshton procedurën e rinovimit të Komoditetit (detyrim për të gjithë zotëruarit e mjeteve të licencuara për transport udhëtarësh e taksit) duke ofruar rinovimin me vetëdeklarim 'online'. "Kontrolli do jetë me short ose te pika e kolaudimit. I zoti i mjetit bëhet përgjegjës për vetëdeklarimin dhe merr certifikatën pa qenë nevojta të dalë çdo vit në komision, pa vërdallosje me mjetin, pa shpenzim kohe e karburantit, por edhe pa burokraci", shkruhet në njoftimin e DPSHTRR.



Përfaqësuesit e AMF-së i njohën të pranishmit me zhvillimet në tregjet financiare që mbikëqyr ky institucion. Në prezantim u evidentuan zhvillimet në fondet private vullnetare të pensionit, fondet e investimeve dhe tregu me pakicë i letrave me vlerë. Te ky i fundit, mbizotërojnë transaksionet mes individëve dhe preferenca për titujt afatshkurtrë të borxhit të qeverisë. Në vijim u theksuan përkjekjet që po bën bursa për të nisur tregtimin e titujve privatë të borxhit dhe të kapitalit, veçanërisht pas krijimit të infrastrukturës bazë për klerimin dhe shlyerjen e tyre. Për tregun e sigurimeve, përfaqësuesit e

## AMF, tregu mbizotërohet nga sigurimi i detyrueshëm motorik



AMF-së evidentuan rritjen e primeve të paguara bruto gjatë 2018, por edhe rritjen më të shpejtë të dëmeve të paguara. Struktura e tregut mbizotërohet nga sigurimi i

detyrueshëm motorik, i cili gjeneron edhe pjesën më të madhe të primeve të shkruara buto. Në kuadër të përafërimit me standardet evropiane dhe për t'iu përgjigjur më mirë zhvillimeve në tregjet e brendshme, të pranishmit u informuan mbi elementët kryesorë dhe stadin e disa projektligjeve të përgatitura nga AMF për veprimtaritë e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe tregjeve të kapitalit.

Grupi Këshillimor do të forcojë masat për përdorimin e lekut

# Sistemi financiar i qëndrueshëm, sektori bankar u zgjerua

Sistemi financiar në vend është i qëndrueshëm, ndërsa veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua, pavarësisht efektit statistikor pakësues, që dha mbicimimi i kursit të këmbimit të lekut. Ky ka qenë përfundimi në të cilin ka dalë Grupi Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF) në mbledhjen e drejtuar nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, ku morën pjesë guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSH), kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), si edhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve. Në prezantimin e Bankës së Shqipërisë u theksua se gjatë 2018-ës zhvillimet ishin përgjithësisht pozitive, tregjet financiare funksionuan normalisht, ku vëllimet e transaksioneve mbetën të qëndrueshme dhe normat e interesit mbetën në nivele të ulëta.



Transaksioneve mbetën të qëndrueshme dhe normat e interesit mbetën në nivele të ulëta. Veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua, pavarësisht efektit statistikor pakësues, që dha mbicimimi i kursit të këmbimit të lekut. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezeve të veprimtarisë ishte i kontrolluar.

### TREGUESIT E RREZIQEVE

Treguesit e rrezeqeve të tregut nuk shfaqën ndryshime gjatë vitit, por mbetet i nevojshëm vlerësimi i kujdesshëm i ndikimit të tërthortë të kursit të këmbimit dhe të normave të interesit. Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rrezeqet vlerësohet e fortë në kushtet kur gjendja e likuiditetit është mjaft e mirë dhe kur veprimtaria bankare paraqitet fitimprurëse dhe e mirëkapitalizuar. Në prezantim u evidentuan edhe ndryshimet strukturore, që kanë ndodhur në sektorin bankar deri në tremujorin e parë të 2019-ës, të cilat janë shoqëruar me rritjen e kapitalit vendës në bankat e sektorit. Krahas konsolidimit të sektorit bankar, ky zhvillim pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e kreditimit. Të pranishmit u njohën gjithashtu me nisat e përmirësimeve të ndryshme ligjore dhe rreg-

ullative, në fushat e mbikëqyrjes mikro e makro-prudenciale dhe të sistemeve të pagesave. Ndryshimet e propozuara në ligjin për sistemet e pagesave, pritet të zgjerojnë mundësitë që avancimet teknologjike të përmirësojnë aksesin e publikut në shërbimet financiare me kosto më të ulët dhe me shpejtësi më të madhe. Kjo do të ofrojë përfitime konkrete për grupet e caktuara të interesit dhe transaksione të rëndësishme për ekonominë e vendit, ku përfshihen edhe dërgesat e emigrantëve. Në shkallë më të gjerë, këto ndryshime pritet të kontribuojnë ndjeshëm në drejtim të formalizimit të ekonomisë dhe të rritjes së ndërmjetësimit financiar.

### SISTEMI FINANCIAR

Pas diskutimit, drejtuesit e institucioneve vlerësuan pozitivisht zhvillimet në sistemin financiar, në tregjet financiare dhe në kuadër rregullativ përkatës, duke konfirmuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Ata theksuan rëndësinë e monitorimit të zhvillimeve financiare dhe të përshejtimit të procesit për miratimin e projektligjeve të përgatitura, për të trajtuar problemet përkatëse dhe për të siguruar përafërimit me standardet më të mira në fushat respektive.

## REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (Consulting Company)

ALBANIA  
CITIZEN – CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT  
Loan Agreement  
Project ID No. 8521

Assignment Title: "The preparation of detailed design for integrated service Delivery centers (ISDC) Lushnje and Elbasan, and supervision for ISDC Lushnje"  
Posted: April 08, 2019  
Ref. No. Ref. AL-8521-CS/CQ/2.05.09

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" entails a multi-layered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency. As part of the reform, in October 2014, ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, was established to manage the centralized public service delivery to the citizens.

Project Implementation aims the refurbishment and reconstruction of the selected premise, which is expected to improve the quality of services for citizens by being closer to the public with the offered services.

The scope of this assignments consists in preparation of the design and environmental checklist of the following activities:

- Task 1: Preparation of the Designs for ISC Lushnje and Elbasan
- Task 2: Cost Estimates, drawings and relevant documents of the envisaged refurbishing works for ISC Lushnje and Elbasan.
- Task 3: Supervision of works during reconstruction of ISC Lushnje

### COMPANY QUALIFICATIONS

The interested Consultants have to comply with the following minimum qualification requirements:  
-The Consultant and its staff must be licensed on the specific categories stated in accordance with Albanian Law. (In design, implementation, supervision of works and environmental studies)  
-The tasks shall be performed by Consultant with proven relevant technical experience.  
-The consultant must have at least 5 (five) years in design and supervision.  
-The consultant must have at least two similar contract including the design and the supervision of works within 5 (five) last years.  
The consultant (its staff) should be licensed in design, implementation and supervision works. Licensed in carrying out environmental studies.

### Key personnel/staff

#### Project Manager

#### 1 (one) Senior Architects / Designers

Licensed architect, with more than 12 years of experience who has a design or technical focus and is responsible for significant parts of the project and worked in at least in 2 similar projects

Very good command of English language

#### 2 (two) Architect / Structural Engineer Licensed architect with 8-10 years of experience who shall be responsible for significant aspects of projects.

- Good command of English language

#### 2 (two) Civil Engineer (s) consultants with at least 10 years of general experience and worked in at least 2 similar projects

The civil engineer(s) shall focus on design work and on the physical aspects of the design.

- Good command of English language

#### 2 (two) Mechanical Engineer graduate degree in field related with mechanical installations

- At least 5 years of general experience at the position of mechanical Engineer of design and/or supervision teams

#### 2 (two) Electrical Engineer

- electrical Engineer with graduate degree in field related with electrical installations

- At least 5 years of general experience at the position of electrical Engineer of design and/or supervision teams

#### 2 (two) Quantity Surveyor

- Quantity Surveyor Engineer, or technician able to check and measure the work quantities

- At least 5 years of general experience at the position of quantity surveyor of design and/or supervision teams

#### 2 (two) Environmental Specialist

- Environmental Specialist with graduate degree in environment

- At least 5 years of experience in environmental issues

The Project Management Unit now invite eligible "Consultants" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualification (CQ) Method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The ROI is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): [www.adisa.gov.al](http://www.adisa.gov.al).

Expressions of interest (Company Profile, CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by April 23, 2019, at 12:00 local time

### ADISA

(Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)

Blvd: Zhan d'Ark,

Ish shtëpia e oficerave, Kati VI-te

Tirana, Albania

E-mail: [roland.larashi@adisa.gov.al](mailto:roland.larashi@adisa.gov.al);

[fiorentina.jorgji@adisa.gov.al](mailto:fiorentina.jorgji@adisa.gov.al)

[informacion@adisa.gov.al](mailto:informacion@adisa.gov.al) and

# Formula e OKB-së për rininë: Fuqizim, integrim dhe barazi

"Deutsche Welle"

Të rinjtë e mbledhur në sallën 12 disku tojnë për problemet e të rinjve në Europë dhe në Amerikën Veriore. Në sallat e tjera, të rinjtë tjerë flasin për problemet e rinisë në kontinentet e tjera. Forumi rinor i OKB-së, organizuar nga ECOSOC, Këshilli Ekonomik dhe Social. Forumi ka mbledhur qindra të rinj në selinë e OKB-së në Nju Jork, që të diskutojnë me ministra dhe zyrtarë të organizatës, për të përcaktuar rolin e rinisë në "Agjendën 2030". Rinia duhet vendosur në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky është synimi, në një kohë kur bota po merret me pasojat e globalizimit.

Të rinjtë e mbledhur këtu nuk janë si Greta Thurnberg, aktivistja 16-vjeçare në mbrojtje të klimës. Të rinjtë e mbledhur këtu janë të veshur me kostume.

OKB-ja përcakton se rinia për të ka moshë 15 deri 24-vjeçare. Por, shton se rinia është kategori fluide më shumë se sa moshë fikse dhe me rini quhet ajo kategori popullore, që ndodhet në kohën e shkollimit dhe të futjes në punë për herë të parë. Secili vend e përcakton vetë kë pjesë të popullsisë që rini, por UNICEF kërkoi të bëjë unifikimin e definicionit. Moshë 15 deri 24-vjeçare përbën 16 për qind të popullsisë së botës, duke arritur shifrën e 1.2 miliardë vetave.

## NEVOJAT E TË RINJVE NË NIVELE RAJONALE

Një nga çështjet rajonale është a janë adaptuar politikat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivele lokale për të arritur synimet e "Agjendës 2030". Shembujt që vijnë thonë edhe 'po', edhe 'jo'. Nga SHBA-të, një shembull është se qeveria federale ka bërë adaptimet, një shembull është se adaptimet për klimën nuk janë bërë dhe qeveria federale nuk i merr ato seriozisht. Një pjesëmarrëse nga Norvegjia thotë se nuk bëhet sa duhet në shkolla dhe nga sektori publik. Në përgjithësi në Europë synimet e zhvillimit të qëndrueshëm nuk kanë mbërritur në nivele lokale. Në luftën kundër



marginalizimit, nga Kanada vjen shembulli i Kampusit të Universitetit të Torontos, ku burimet për trajtimin e shëndetit mendor janë zvogëluar, megjithëse numri i vetëvrasjeve nuk ka rënë. Një pjesëmarrëse nga Turqia flet për shkollimin e refugjatëve në moshë të re, për të cilët nuk bëhet sa duhet nga komuniteti

ndërkombëtar. 1.8 milionë refugjatë janë në moshë shkolle dhe 30 për qind e tyre nuk shkojnë në shkollë. Një i ri nga Kamboxhia që ka imigruar në SHBA, kërkoi që të rinjtë emigrantë të mos kthehen: "Ne kemi bërë rrugë të gjatë për të ardhur deri këtu. Dhe nuk duam të kthehemi", përsërit ai disa herë. Për diskriminimin e

të rinjve, një vajzë sjell shembull nga qyteti i Nju Jorkut, ku ndarja racore

## BOTA

Rinia duhet vendosur në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm. Forumi rinor i OKB-së në Nju Jork diskuton me ministra dhe zyrtarë të organizatës për të përcaktuar rolin e rinisë në "Agjendën 2030".

ka krijuar një hendek në sistemin e arsimit. Një pjesëmarrëse flet për Bullgarinë, diskriminimin e romëve në sistemin e arsimit dhe punësimit atje, bullizimin, diskriminimin gjinor dhe mosratifikimin nga Bullgaria të konventës kundër diskriminimit gjinor.

## DISKRIMINIMET E NDRYSHME

Një pjesëmarrëse flet për diskriminimin kundër myslimanëve, një tendencë globale. Ajo tregon për përvojën e saj si grua, që e detyrojnë të heqë shaminë nga koka kur udhëton në Evropë për biznes. Diskriminim kundër myslimanëve bëhet edhe nga tregu i punës në shumë vende.

## SI NDIKON TEKNOLOGJIA NË ZHVILLIM?

Një pjesëmarrëse nga Mbretëria e Bashkuar flet për mbetjen mbrapa të të rinjve që nuk kanë mundësi të financojnë telefona celularë dhe kompjuterë. Një pjesëmarrëse thotë se paqja dhe siguria duhet të jenë temë për të rinjtë edhe në Europë,

megjithëse shumëkush mendon se atje sundon paqja dhe nuk është e nevojshme. 1 në 4 të rinj në botë ndodhet nën ndikimin e një konflikti të armatosur. Një tjetër flet për diskriminimin që u bën ligji të rinjve për shkak të moshës për të marrë poste të caktuara. Në shumë vende ekziston diskriminimi për shkak të moshës, që vendos barriera për zgjedhje në poste të caktuara. 73 për qind e vendeve kanë kufizime moshe për marrjen e posteve të caktuara mbas moshës 35 ose 40-vjeçare. Kurse një pjesëmarrëse flet për praktikën që nuk paguhen, madje edhe në agjencitë e OKB-së. Prandaj, organizata ka marrë vendim që pas 2020-ës, të gjithë të rinjtë që bëjnë praktikë të paguhen. Këto janë disa nga nevojat rajonale të të rinjve nga Europa dhe Amerika e Veriut, në bazë të të cilave do të përpilohen rekomandimet për politikëbërësit. Forumi rinor do të përfundojë me një deklaratë presidenciale, që do të lëshohet pas dy ditësh këshillimesh.



info@primall.al

www.primall.al

Shoqëria PRIMALL shpk, distributor i autorizuar për Shqipërinë e markave të kompanisë ndërkombëtare "JT International", njofton mbi cmimin e produktit të ri që do të tregëtohet duke filluar nga data **15/04/2019** i cili është si me poshte

Marka	Cmimi përfundimtar me date 15 Prill (TVSH e përfshirë)
Winston XStyle Silver Long	230

Njoftimi behet ne perputhje me udhezimin Nr.6 date 30/01/2015 te Ministrise se Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"( i ndryshuar)

**SHPALLJE ANKANDI**

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përmbanues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 26.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z.Shpëtim Barjam Boci:

- Truall me sipërfaqe 2863 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 63,712 (Gjastëdhjet e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 2317 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 55,608 (Pesëdhjet e pesë mijë e gjashtëqind e tetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 790 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 18,960 (Tetëmbëdhjet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) EURO
- Truall me sipërfaqe 780 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 18,720 (Tetëmbëdhjet mijë e shtatëqind e njëzet) EURO
- Truall me sipërfaqe 1750 m<sup>2</sup>, Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjrokastër, me vlerë fillestare në ankand 42,000 (Dyzet e dy mijë) EURO

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Rr.Ibrahim Rugova  
Pallati Kontakt nr.10, Kati 4  
1000 Tirana, Albania  
t. +355 44 500 909  
f. +355 44 500 910



Kush nuk paraqitet për të kryer kontrollin mjekësor, del nga skema e KMCAP Epror

ISSH publikon listën, 310 personat që nuk të veyjnë kontrollin mjekësor
Dokumentet i dorëzohen mjekut të ekspertizës

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka shpallur emrat e personave që do t'u nënshtrohen kontrolleve mjekësore në KMCAP Epror gjatë muajit prill për të marrë pensionin. ISSH publikoi dhe listën me emrat e 310 personave që duhet të kryejnë ekzaminimet brenda muajit pranë Komisionit Mjekësor të Aktimit të Aftësisë për Punë.

KONTROLLI

Individët që kanë emrin në listë duhet të paraqiten për kontrollet sipas datave dhe orareve që ka caktuar ISSHJA. Në rastin që nuk do t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nuk do të mund të marrin ora mirim pensionin në invaliditet nga ISSH. Të gjithëve atyre personave që bëhen të paafte për çdo veprimtarë ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjymtime të forta, duke përfshirë verbinim, lu lind e drejta për pension invaliditeti. Për të

përfutur këtë lloj pensioni të plotë, të reduktuar dhe të pjesëshmë, përfuttes ose i autorizuar me prokurë paraqitet në ALSSH-së së vendbanimit, sipas regjistrimit në gjendje civile, për të bërë kërkesën e përfuttes të pensionit të invaliditetit. Përfuttes i autorizuar me prokurë, së bashku me kërkesën, duhet të paraqesë edhe dokumentet që

vërtetojnë moshën e identitetin, ato që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si dhe dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara e gjendjen shëndetësore. Ky dokumentacioni dorëzohet mjekut të ekspertizës, i cili pas verifikimit njofton datën për të kaluar në KMCAP, ose i kthen mbarsht dokumentet për pasaktësi. KMCAP-i m bledhjen e tij

shyrton paraprakisht dokumentet, njofton dhe ekzaminon të sëmurin, merr vendim përkatës jo në prani të tij dhe kryetari i KMCAP-i ia komunikon zyrtarisht të sëmurit gojtarisht dhe nëpërmjet veprimtarit tip. Kundër këtij vendimi i sëmuri ose invalidi mund të ankohet te KMCAP-i Epror. Ankesa bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DRSSH-në përkatëse.

LISTA E PERSONAVE QË DO TË PARAQITEN NË KMCAP EPROR PËR MUAJIN PRILL 2019. Table with columns: Nr., Emër, Mbiemër, KMCAP, Data, Ora, Rrethi. Includes sections for Kardiologji, Neurologji, and Psikiatri/Oculist.

Table with columns: Nr., Emër, Mbiemër, KMCAP, Data, Ora, Rrethi. Continuation of the list of names and details for the medical examination process.

Table with columns: Nr., Emër, Mbiemër, KMCAP, Data, Ora, Rrethi. Continuation of the list of names and details for the medical examination process.

Pronarët duhet të tërheqin dokumentin në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive

# Hipoteka, 1100 personat që kanë gati tapitë e shtëpive

## Përfituesit e certifikatave në qarkun e Elbasanit

Publikohet lista me 1100 pronarët që kanë gati certifikatat e pronësisë. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit, ku përfshihet Librazhdi, Gramshi, Peqini, Belshi, Cërriku dhe Përrenjasi. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Elbasan, publikon listën me 1100 personat që kanë përfutur lejet e legalizimit dhe që duhet shkojnë në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të aplikuar për certifikatë pronësie.

### TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon

dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapitë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për

regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për

ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m<sup>2</sup>. Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas

vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i

pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit.

### PERSONAT QË KANË GATI TAPITË E SHTËPIVE

BUJAR XHINA  
BEQIR HAZIZI  
ALBERT LALOSHI  
ZENEL KOLORIU  
AGIM SULA  
SABRI SALLA  
MURAT AHMATI  
SKENDER BAJRAMI  
REFIT JOLLA  
XHOVDËT MOLI  
GENTJAN TASHI  
LUFTAR MUCA  
ALI PISHA  
ALFRED MUSTA  
SKENDER MUCA  
RESMI BARDHI  
MIKEL MISHA  
ARBEN VELI  
AGRON KUSHTI  
ZEDEF HOXHA  
ZEDEF HOXHA  
ILIR XHAFERRI  
YLLI KUSHI  
GEZIM SENE  
ARTUR HYSËNI  
ARDIAN KOSTURI  
MYFTINIA ELBASAN  
FIQIRET KARAJ  
HYSNI TERA  
FESTIM QOSJA  
ARBEN BROSHKA  
FAIK HANKO  
VASIL HANKO  
HASIM CARCIU  
HEKURAN BRUSHLI  
FLORAT HANKO  
DRITAN HANI  
RAMAZAN CERRIKU  
PASHO MISHA  
FATJON KORRA  
MAHIR BUDANI  
DILE DEDA  
INDRIT BICI  
XHEVIT PISHA

NAIM KULLA  
SHEFIT MUSTA  
PULLUMB QOSJA  
FADIL MALOKU  
ENEA META  
SAIMIR ZEJNELI  
XHEMILE BARDHI  
XHEMILE BARDHI  
FAIK SAMURRI  
MYFTINIA ELBASAN  
MIMOZA DUKA  
HYSNI KOLONJARI  
ILIR CORA  
ILJAZ TOPI  
FLAMUR OSMANI  
YMER LUKANI  
ISA MUSTA  
ATMIRIM RUSTA  
KRENAR TAFANI  
ALBERT CAPO  
FAIK SHKURTI  
FAIK LIKA  
SKENDER RUSTA  
DASHAMIR SADUSHI  
BESIM MUCA  
ILMI MUSTA  
DASHAMIR ZYBA  
VEIS CAPO  
MEHMET KERA  
FATMIR ZEROLLARI  
QANI MUCA  
FAIK TAFANI  
AGIM LLESHI  
SYRJA PEPA  
SHPETIM QYRA  
ISMAIL TAPA  
ARBEN XHAJA  
ARBEN CELA  
QANI ELEZI  
JANI CANTO  
BESNIK KERA  
FATOS KERA  
SHABAN BALLA  
ERVIS LLESHI

HEKURAN TOSKA  
VASIL GERDANI  
JAKUP HYSËNI  
HAMDI SALLA  
PATRIOT XHAFERRAJ  
FEMIR SULA  
KODHEL CALA  
SHEFQET XHARDJA  
AGRON BALLA  
GJERGJI KANACO  
ERION HAZIZI  
FOTO PRIFTI  
AVDULLA HUSHI  
YLLI BUZANI  
KADRI NERGJONI  
AVNI NERGJONI  
KUJTIM GOGA  
MINELLA DUKA  
TAHIR SAMURRI  
FIQIRET SAMURRI  
BESNIK HASA  
PETRIT LALOSHI  
DASHNOR OMERI  
ILIR OMERI  
ALTIN SHARA  
AGRON SHARA  
AGRON SHARA  
DURIME CANI  
ARBEN HOXHA  
YLLI SHARA  
SERVET XHARDJA  
VISLET SHULI  
MUSTAFA ISLAMI  
ARIAN BARDHI  
NEZIR PAJA  
DENARDO ISMAILI  
EGLANT KOCI  
ARIF KISHITA  
YLLI BAJRAMI  
QAZIM RIKA  
DASHAMIR ELEZI  
QANI ELEZI  
LAVDIM MUSAJ  
MEHMET BAHJA

ALI LAMCJA  
PELLUMB GURRA  
CAPAJEV BAHUSHI  
CAPAJEV BAHUSHI  
ASTRIT SHIMA  
LUAN TASHI  
SHPETIM MOLLOSMANI  
EDLIR MULLOSMANI  
VIOLETA KYCYKU  
RAMAZAN XHARDA  
BLEMOR BOCI  
ASTRIT GURABARDHI  
LUFTAR MUCA  
SEFER BODURRI  
MYFTINIA ELBASAN  
MYFTINIA ELBASAN  
TOMORR QOSJA  
DYLAVER GURABARDHI  
ENVERE LEPURI  
QANI KULLOLLI  
AGIM BODURRI  
SALI ELEZI  
BLERIM METUSHI  
REXHEP ASLLANI  
GAZMENT STAKA  
AGIM DYMYSHI  
KADRI SINANI  
SOKOL KOCI  
ANDROMAQI PAXHI  
SHKELQIM SHARRA  
RAJMOND SHATI  
MYFTINIA ELBASAN  
ARTUR MURATI  
ILIR PISHA  
BAHRI XHAFERRI  
HAVA TURKA  
LUAN CEKOJA  
ISUF HANOLI  
ALFRED KUMRIA  
GENTJAN JUPA  
LULZIM PASHTANJAKU  
ADRIATIK DEDJA  
FLAMUR ZDRAVA  
EDMOND ELEZI

GENCI MULLOSMANI  
PETRIT JUPA  
FERIDJAN KULLOLLI  
IZET PASHTANJAKU  
ALBERT QOSJA  
FLAMUR BAJRAMI  
XHAVIT BAHU  
SHKELQIM CEKREZI  
TOMORR TOLLUMI  
PERPARIM SENJA  
GEZIM CEKINI  
SOKOL QOSJA  
EDMOND LUMSHI  
BASHKIM BOJA  
GJERGJI MISHA  
NAZIF SAMURRI  
RAMAZAN SAMURRI  
ADILE CARKU  
NAZMI META  
ALIM SULI  
PIRO VERUSHI  
ADRIATIK QYPI  
GURI AGOLLI  
DHURIM ISMAILI  
HODO RIKA  
EDMIR ELEZI  
AVNI BROSHKA  
ARDIAN LLESHI  
NEZIR QOSJA  
RYZHDI PLAKA  
DEMIR XHELILI  
ARDIAN RAGA  
KADRI DYRMYSHI  
KLODIAN QYRA  
BASHKIM GOGA  
LUAN PISHA  
IBRAHIM CELA  
SAMI BOJA  
VASILLO BELLO  
EDMOND CARKU  
MEHMET LECI  
BESNIK HIDRI  
KLEO CARKU  
SPIRO NERGJONI

NAIM BARDHI  
FATMIR SINANI  
QERIM PISHA  
SULEJMAN TATA  
FATOS QOSJA  
VASIL JOSIFI  
KADRI PISHA  
FETI CEKOJA  
ARQILE MISHA  
BERTI QOSJA  
ARIF ZHUPANI  
HYSËNI BICA  
PETRIT META  
ARBEN ISAKU  
PETRO BALLIU  
SALI META  
MEHMET ESHJA  
ANXHELO SAMURRI  
MUSA MALOKU  
EMILJAN ZEJNELI  
FATOS SULA  
EDMOND BOZHIQI  
AGRON TAFANI  
SAIMIR TAFANI  
TEQJA SALI BABA  
SHYQYRI HASA  
THOMA GUXHO  
ARBEN DUKA  
AGIM MIFTARI  
NAZMI ZYLI  
SELIME HYSËNI  
XHEVIT CEKREZI  
PETREF ASLLANI  
MIRELA CERRIKU  
NEBI CEKREZI  
SHEFQET QYRA  
HEKURAN SAMURRI  
ETLIR SHABANI  
AGIM META  
BESNIK KUKU  
MEHMET PISHA  
AGIM KUKU  
XHEVIT GJINI  
SHYQYRI KOCI



XHEMALI SAMURRI	RAMIZ KORRA	QAMILE KARAJ	LEONARD SULANJAKU	AGRON QOSJA	KUJTIM PEPA
FLUTUR METOSHI	HAXHI HOXHA	BASHKIM IBRUSHI	ALEKSANDER CULLHAJ	KUJTIM BODURRI	VLADIMIR ASLLANI
FLORJAN CANGOJA	ZENEPE ALLA	KADRI POKA	KAMER BALI	ARBEN KASA	RUSHAN LATIFI
MERSIN LLESHI	SHKELQIM TAFJA	NAZMI SHAHINI	PASHO BAHA	REXHEP SENA	SAMI GAXHJA
RAMAZAN SUBASHI	ASTRIT ELEZI	BARDHUL BEQIRI	NEXHIP XHYRA	HYSEN KUQJA	DEMIRE SENI
SHPETIM CEKREZI	RESUL MALIQI	DHIMITER KARAJ	BUJAR META	HETEM BENO	AVDI HOXHA
FADIL SAMURRI	MEHMET DAJA	LEFTER PELLUMBI	FUAT HASANI	HALIT LEKA	RAMAZAN GJONI
FAIK KALARIA	FEIM CARCIU	XHEVAHIR NERPJETRI	RIZA VLLAHI	QANI SHERMADHI	GEZIM DAULLJA
ALTIN CANGOJA	FAIK BEQIRI	ANDREA SHKALLA	TAQI BERDUFU	FLAMUR TAFJA	ASTRIT SHIMA
PALUSH VOJA	Janixhyra	ANDREA HALIMI	FEIM MUCA	FIDAIR CAKO	RRAHMAN ELEZI
KOSTJAN CAKALLI	XHEVDET MURATI	JANI BODURRI	SHEFQET HAKA	AGIM QOSJA	ELTON SHATI
VENEMIN BALLA	BAFTJAR DEBROVA	PETRAQ DEDJA	BULETINA FACI	JANI CAKO	MYSLIM DEBROVA
TAJAR LLESHI	RRAPUSH KARAJ	ROLAND HYSJA	HIDAJET SINA	SEJDIN HOXHA	BASHKIM AGO
ERNESTO HAZIZOLLI	SHAQIR PISHA	GENTJAN LAMCJA	RAMAZAN MATRAXHIU	MALIQ HOXHA	KUJTIM RRESHKA
SERVET LIKA	QAMIL BOCI	SHEFQET MIRAKA	KUJTIM SKURA	EDMOND BILANI	XHEMALI QUKU
XHEVAIR LLESHI	LUTFI PISHA	SAIMIR LIKA	FASLLI BROSHKA	AGIM MUCA	MINUSH VERCANI
NAZMI TABAKU	XHEVIT BARDHI	FITNET KOFSHA	ARBEN CAKA	ASTRIT SHERMADHI	SERVET RAMA
IKE LLESHI	ALBERT SINA	HEKURAN CELHEMA	BAJAME PEPA	DALIP VERCANI	REFAT CEKA
NIKOLLA ZAIMI	BAKI LLAHA	KUJTIM XHYRA	FAIK BAJRAMI	JANI KURTINA	AGIM CEKOJA
ISLAM TAFJA	BESMIR DUKA	HEKURAN SHTYLLA	ROLAND CELA	VIKTOR BALI	FATOS SINANI
DURIM ASLLANI	MISIR KUKA	IBRAHIM CARKU	ISA CELA	SELMAN LICI	AGUSH GURABARDHI
PETRIT IBRO	HYSNI HAKA	SEJRIJE GORICA	SALI ALLUSTAJ	GENCI PEPA	ISLAM XHERRI
FESTIM SHKURTI	FATMIR SALLA	THANAS DULJA	TANE GJINI	ASTRIT PEPA	LIRI BAHA
XHEMAL STAFJA	NUREDIN DUSHKU	ARBEN CELA	BUJAR TUFJA	DURIM KUQJA	ZUHDI URUCI
SAMI BICA	TAULAND XHYRA	PERPARIM KABASHI	AGIM SHARRA	RESHIT KURTI	FATOS SOLLAKU
QERIM MISKA	JASHAR PISHA	SHPRESA KUKA	ILIR LECI	ARDJAN KUME	BUJAR ELEZI
JAKUP BALLIU	LUAN KUKA	GENTJAN PALI	PRANVERA ISLAMI	APOSTOL BODURRI	SHERIF POPA
RRAPUSH ZAVALINA	FADIL CANGOJA	FABJAN KORRA	KUJTIM ROCI	SANIJE ELEZI	SHYQYRI ZIKA
VJOLLCA LEKA	JANIS RUCI	ASLLAN PISHA	FERDI KOLLCAKU	GEZIM LALOSHI	SALI CARCIU
SERVET NUREDINI	NEZIR BAHU	ARBEN VLLAHI	BESIM LISI	GAZMIR SKENDERI	TAULANT LLAHA
ARBEN KACULI	MEHMET HASA	GAZMIR PEPA	FAIK ALLUSTAJ	NAIM TAFANI	TOMORR BALLA
ASLLAN SULI	NAZMI KASA	ASTRIT KOMINI	BEHAR SULA	BESNIK META	MURAT AHMATI
XHEVAHIR BARDHI	ADILE BAXHAKU	KLAJDI BAKALLI	YLLI FAHRIU	SAIMIR BODURRI	BLERIM HASKJA
HYSNI XHARDJA	MYZAJETE KANA	GEZIM PISHA	FLORENC CALA	ARJAN DUZHA	KADRI HIDRI
KADRI KRYEMADHI	FERIT HALLA	MEHMET HUSHI	MAJLINDA CERENI	REXHEP GJONI	ERVIS HIDRI
XHEVAIR LLESHI	FATI KIKIJA	YZEIR KRYEMADHI	YLLI LAMCJA	XHEVIT MURATI	FATMIR CARKU
SERVET LIKA	LUTFI CELA	ILIR HASA	DRITA BAHA	ILIR KRYEMADHI	FATOS HALIMLLARI
ERNESTO HAZIZOLLI	BARDHUL META	VULE MUCA	MEHMET BICA	IBRAHIM HOXHA	KUJTIM CEKANI
KLODIAN AJREDINI	ELTON MURTINI	BASHKIM SOLLAKU	BESIM CARKU	QERIM KUKA	FERIT MJESHTRI
VULLNET NUREDI	ILIR PAJA	IZET HANKO	ARDIAN HAZIZI	ABAZ LOKA	XHEVAHIR ALLA
DORIAN KABASHI	BERTI ABEDINI	ISMAIL BOZHIQI	LORENC KAZA	DAFINA ISUFAJ	SHERIF GJINI
AGIM LICI	MEFAIL GJOLENA	BASHKIM RUCI	ARBEN PISHA	ABAZ MALJA	FATMIR META
LENCI MURATI	DYLBER XHEMALLARI	BESNIK GJEVORI	LEME NUKA	BLERIM KUQJA	XHEVAHIR SAMURRI
ARBEN LECAJ	SULEJMAN SHEHU	FAIK DRIZA	BASHKIM SINA	ALEKSANDER GJYLA	MUSTAFA KOLA
AGRON PISHA	AVNI RAMZANAJ	MAREGLEN XHARDA	AZEM LECI	RYSTEM SULMINA	MUHARREM HOXHA
RESHAT CAKA	FAIK META	LUAN NERPJETRI	DRITAN ALLUSTAJ	ILIR MUCA	IDAJET HYSJA
ALMA QEVANI	SELAMI TABAKU	PANAJOT DURRO	SHEKLQIM CURA	SELMAN PLAKA	VAIP HASKJA
HEKURAN MUCA	ALI KUKA	ASTRIT SOLLAKU	XHEVAHIR GJIKJA	ISUF BROSHKA	BESIM RAMA
SHYQYRI KULLOLLI	MENTOR PLAKU	MARINA VERUSHI	VENEMIN QOSJA	KASEM METHASA	FLAMUR HYSJA
SOKOL SULA	DHURIM DERVISHI	LIMON KALOTI	BESNIK PISHA	ILIR TAFANI	MISIR HASKJA
HYSNI HIDRI	ALFRED CELA	SELIM HAKA	EKISJO METUSHI	TAJAR BULLARI	IDLIR KUMRIA
SELIM RUCI	RAMADAN CARCANI	TAHIR QYPI	ARJAN MURATI	ARBEN REXHEPI	GENTIAN MURATI
LEDJAN LATIFI	AISHE AGOLLI	AGIM SKENDERI	ARBEN SHABANI	MUSTAFA OMERI	ANTONJO SULANJAKU
DHIMITER SHYTI	HAVA TOROMANI	BLERIM SHTYLLA	HALIT KULLOLLI	MEXHIT BAHA	ARGJENT ISMAILI
ROLAND BUZRA	JAKUP ALLIU	KASTRIOT SHTYLLA	ANI SALLA	HYQMET LLESHI	MUSTAFA KROZI
BUJAR TAFJA	SHEME RUSTA	ALBERT PEPA	RUSTEM KRASNQI	BAJRAM KASA	GEZIM LICI
IBRAHIM CEKREZI	IDAJET QOSJA	ILIRJAN XHYRA	BUJAR ZOTO	ALEKSANDER CAKALLI	LULZIM SHERMADHI
ILIRJAN CANO	BAFTJAR DRAGOTI	DURIM BULLARI	PELLUMB RUCI	ALTIN BODURRI	PELLUMB SHERMADHI
BUJAR RUDA	FATMIR SKENDERI	KADRI BAXHAKU	LILE BOCI	LIMON BAHA	FERDINANT KUSI
BASHKIM BALLA	QEMAL SENJA	BARDHUL KUSI	ASTRIT CERENI	ERVIS CEHU	SAIMIR KASA
ERMIR CELA	XHEMIL ALIU	ARBEN DRIZARI	SOKOL LECAJ	SOKOL TAFJA	DASHAMIR PEPA
PELLUMB KOLLARE	FATMIR DOKO	ARDIAN XHAFERRI	MIMOZA HOXHA	SHEFQET ROCI	SHPETIM KICKA
HEKURAN ELEZI	ERJON MUSAI	OSMAN ABAZI	SHOQATA E TE	ADIL KURTI	XHEMALI SHABANI
SHKELQIM KOTKA	ALBERT SKORRA	TAULAND XHAKA	VERBËRVE	PETRIT DERVISHI	KUJTIM HASANI
FAIK KURANI	PELLUMB BAHU	ARBEN XHIJA	NAIM DYRMA	DASHAMIR HOXHA	MIRELA METANI
SKENDER CARCIU	ARJOL BAHA	ROLAND BIBA	HASAN BULLARI	TAULANT CAKALLI	KASTRIOT ZDRAVA
TAJAR LLESHI	GENCI LLESHI	MYFTINIA SERICE	HALIT TUFJA	ILIR MURATI	FATMIR SHERMADHI
ZYDI BOZHIQI	QERIM GJEVORI	MYFTINIA QAFE	ANDREA XHAKOJ	QEMAL MEHALLA	ASLLAN REKA
VASIL TOLLUMI	MYFTINIA BROSHKE	ARI RUSTA	ALBERT CAKA	LINA HYSENBELLI	RRAPUSH SOLLAKU
SAMI XHARDJA	JONUZ GJEVORI	HAFIZE DUKA	VELI CERRIKU	NDRICIM BARDHI	HYSNI ROCI

Rrëfihet parukieria: Trendet më të fundit të modës, çfarë kërkojnë këngëtares

# Merita Merja:

## Ja si është të punosh mes VIP-ave shqiptarë

"Konkurrencën nuk e kam parë asnjëherë"

Egla Xhemali

Sapo futesh në sallinin e saj të bie në sy një frymë miqësore, me të cilën ajo u flet vajzave kursante. Një rrugëtim i mbushur me mbresa, për të përcurur të bukurën e shpirtit në punën si grimiere dhe stiliste flokësh. Merita Merja është artistja e transformimit të pamjes së VIP-ave shqiptarë. Ajo vjen në një rrëfim për "Gazeta shqiptare" për pasionin e saj dhe për punën me personazhet publik. Merita na zbulon disa truke, me të cilat arrin të bëjë mrekullira në imazhin e shumë vajzave. Merja është e apasionuar pas ngjyrave dhe ka një fantazi të jashtëzakonshme në mënyrën se si do të bëjë ndryshime në pamjen e klienteve. Këto të fundit i qëndrojnë besnike duke marrë dhe këshilla prej saj. Më tej, Merita ndan me ne eksperiencat me personazhet e njohur publikë e ashtu edhe të tyre për kurimin e pamjes. Për grimieren dhe stilistin e flokëve madhështia e tyre qëndron në faktin e të qenit të thjeshtë.

Grimierja e njohur Merita Merja

**Na trego diçka për veten, si nisi rruga jote drejt së bukurës?**

Merita është një njeri i thjeshtë që e ka nisur rrugën e bukur të parukerisë me dashuri dhe pasion. E kam dashur gjithmonë këtë gjë dhe me punë ia arrita.

**Çfarë ka kaq të veçantë Merita?**

Ka të veçantë singulitetin, dashurinë për punën dhe origjinalitetin në ide dhe fantazi.

**Nëse nuk do ishe bërë stiliste flokësh, çfarë profesioni do zgjidhje?**

Mendoj se do isha bërë një avokate e zonja. E kam dashur gjithmonë profesionin e juristes dhe drejtësinë, prandaj, nëse nuk do isha kjo që jam, do isha me siguri një avokate e mirë.

**Saktësisht një paruki-**



**ere duhet të merret vetëm me flokët apo me gjithçka që ka të bëjë me kurimin e imazhit të një femre?**

Saktësisht një parukiere duhet të merret me gjithçka që ka të bëjë me zbulimin dhe me të bërit të ndihën mirë femrat. Flokët nuk janë gjithçka në parukeri, është një kompleks i tërë që zërthehet sapo hyn në derën e parukerisë, të një parukerie profesionale, bëhet fjalë gjithmonë.

**Cili është raporti yt me ngjyrat?**

Unë shquhem për ide dhe kuptoj që në shikimin e parë, se çfarë ngjyre i shkon një klienteje të caktuar. Edhe ngjyrat janë me personalitet, sepse e kuqja nuk mund t'i shkojë të gjithëve apo bjondia ose e zeza. Kështu, mendohem dhe shpresoj

t'ia kem arritur të realizoj idetë e mia tek klientet që, siç e shikon, janë shumë.

**Në gjithë gjërat që mund të bësh me flokët, për cilën je më e specializuar?**

Për ngjyrat dhe për shtimin e flokëve, për të cilat jam krenare për punën që bëj, sepse janë produkte origjinale dhe që kënaqin dëshirat e klienteve për të qenë të bukura. Tashmë një trend i ri janë dhe gërshetat, të cilat personazhet VIP i preferojnë shumë, duke përmendur Anjeza Brankën, Enxhi Vlashin e shumë të tjera.

**Cila është pika jote më e fortë sa i përket profesionit?**

Të kënaq pafund klientet, që kur të dalin nga dyqani të ndihen më të bukurat në botë. Është parimi im kryesor.

**Një kliente vjen në sallinin tënd me një ide të caktuar për flokët. Si procedon me të?**

Unë mendohem ta këshilloj dhe ta bind se cila i shkon asaj, goftë ngjyrë, goftë stil, pastaj nëse ajo nuk bindet do t'i plotësojmë dëshirën dhe të realizojmë atë që ajo kërkon.

**Çfarë të bindi të merresh me artin e të bërit të bukur të tjerët?**

Dashuria ime për të bukurën. Unë jam një femër që më pëlqen që të merrem dhe të kuroj veten deri në detaje më të vogla, kështu që këtë dashuri për të bukurën përse mos ta transmetoj edhe tek të tjerët. E di që femrat i bëj të lumtura me punën që bëj.

Shoh që në sallinin tënd ka shumë nxënës që po mësojnë artin e parukerisë.



Si është Merita si mësuese?

Unë nuk kam dashur dhe nuk dua të mburrem, por puna flet vetë dhe përderisa kam kaq shumë kursante do të thotë që puna ime pëlqehet. Merita është mësuese e dashur dhe e përkushtuar.

**Po te nusët sa përkushtohesh?**

Jashtëzakonisht shumë, sepse dita e martesës është dita e tyre më e bukur dhe duhet të jetë ajo dita që do mbahet mend prej tyre. Unë mendohem që ta bëj sa më të bukur dhe shpresoj që ta kem arritur në çdo nuse që kam stiluar dhe ato ta kujtojnë veten si më të bukurën në jetën e tyre.

**Në sallinin tënd kurojnë imazhin edhe shumë personazhe publikë apo jo?**

Po është e vërtetë shumë personazhe, duke filluar që nga Enxhi Kamenica, Maja,

Anjeza Branka, Elisabeta Marku e shumë e shumë personazhe të tjerë, që të më falin nëse nuk po i përmend të gjithë.

**Sa të veçantë dhe sa të thjeshtë janë personazhet publikë shqiptarë në syrin tënd?**

Në syrin tim janë të gjithë të mirë, popullorë dhe shumë të thjeshtë.

**Cili është ai personazh, që të ka lënë mbresa të veçanta dhe pse?**

Elisabeta Marku është femër e bukur dhe e mrekullueshme.

**Po personazhi, të cilit i ke bërë stilitim më të bukur të flokëve?**

Nuk dua të bëj dallime, sepse janë të gjithë të mirë dhe të bukur, por Enxhi Kamenicës i përkushtohem shumë, të cilën e kam edhe shumë xhan.


**Konkurrencën si e sheh?**  
Nuk e kam parë asnjëherë.(qesh)





## Arbenita qenka penduar për këtë veprim kur ka qenë me Feron, mësoni përse bëhet fjalë

P<sup>r</sup>ej pak muajsh modelja e famshme Arbenita Ismajli dhe reperi i njohur Fero kanë bërë publike lidhjen e tyre dhe herë pas here në llogaritë përkatëse në 'Instagram' nuk mungojnë fotot romantike. Në çdo postim të tyre ata duken shumë të lumtur dhe dedikimet që i bëjnë njëri-tjetrit janë shumë romantike. Arbenita është shumë aktive dhe mjaft e ndjekur në rrjetet sociale e fotot e saj tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Ditën e djeshme, modelja simpatike ka publikuar një foto në të cilën shfaqet shumë seksi në makinë, ndërkohë që në sedijen e pasme shihet xhupi i Feros. Mirëpo kjo është një foto e vjetër e saj të cilën e fshiu, por qenka penduar për këtë veprim që bëri. Këtë na e tregoi me anë të mbishkrimit që përdori modelja. "Jam penduar shumë që e fshiva këtë foto".



## Mohoj lidhjen me të, por ja si e uron Adrola Dushi modelin shqiptar për ditëlindje

A<sup>d</sup>rola Dushi është një prej modeleve shqiptare më të suksesshme, e cila prej vitesh po e zhvillon karrierën e saj në SHBA. Bukuroshja pranoi dy vite më parë lajmin se është divorcuar nga bashkëshorti i saj Adis Patushi, me të cilin ka dhe një djalë Troin. Por, pas ndarjes, ndjekësit u bënë kureshtarë në lidhje me statusin e Adrolës tani që s'është më e martuar. Së fundmi, ajo ka pozuar krahas modelit simpatik Pavllo Zengo. Në fotot e publikuara nga modelët shqiptarë, ata dukeshin shumë të afert dhe në disa media online u komentuan sikur janë të lidhur. Mirëpo, për këto lajme Adrola nuk reagoi dhe në një intervistë të fundit në emisionin "E diell" la të kuptohej se është beqare. Megjithatë, jo më larg se dje modelja ka publikuar një foto në krah të aktorit dhe modelit bukurosh dhe pranë i ka bërë një dedikim të ëmbël: "Gëzuar ditëlindjen zemra ime", ka shkruar Adrola.



## Të tre njësoj! Festimi i veçantë i Xhensilës me Besin dhe Ajkën

A<sup>j</sup>o është një nga këngëtarët më IN të momentit. E kemi fjalën për Xhensila Murtezajn. Bukuroshen e gjeti ndryshe ditëlindja e saj të 26-të. Këngëtarja u tregua mjaft e rezervuar në rrjetet sociale, pasi nuk ndau asnjë nga urimet që mori, madje as bashkëshorti i saj Bes Kallaku nuk bëri asnjë urim publik për të. Megjithatë, ajo postoi në rrjetet sociale disa foto ku shfaqej teksa po festonte në një vend mjaft të veçantë, së bashku me vajzën e saj Ajkën dhe partnerin Besin. Ndonëse, shumë po prisnin foto të ndonjë feste madhështore dhe me shumë drita, Xhensila zbuloi se ndodhej në kishë duke u lutur së bashku me Besin dhe Ajkën. "Faleminderit At", ka shkruar Xhensila në një foto ku shihet në ambientet e kishës dhe në një foto tjetër ajo tregoi se së bashku me Besin dhe Ajkën mbanin veshur këpucë të ngjashme.



## Ledri Vula paralajmëron diçka të madhe, zbulon ç'po ndodh

L<sup>e</sup>dri është një ndër reperët më të mirë shqiptarë dhe padiskutim shumë i dashur për publikun. Së fundmi, ai ka qenë i ftuar në emisionin "N'drrimi i natës" ku foli për anën profesionale, marrëdhëniet me kolegët, por edhe për jetën private. Gjithashtu, reperi ka folur dhe për dashurinë e tij të dytë që është filmi. I pyetur nga moderatori i emisionit nëse në planet e tij është realizimi i një filmi, Ledri e ka pohuar duke u shprehur se do të kem një film të tij, ku do e shpalo talentin si regjisor. "Të gjithë shohim filma për argëtim, por një regjisor e sheh ndryshe. Nuk mundem pa e realizuar një film, ia kam borxh profesorit tim, Isa Qosjes, sepse më ka shkolluar. Filmi është arti më i madh", është shprehur Vula. Kujtojmë që Vula ka mbaruar regjisorë me një mesatare të lartë.



## Kosova nis procedurat për ratifikimin e Konventës së Stambollit

Institucionet e Kosovës kanë nisur procedurat ligjore, të cilat mundësojnë më pas ratifikimin e Konventës së Stambollit, e njohur në botë si instrumenti më i mirë ligjor, për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Komisioni për legjislacion në Kuvendin e Kosovës bën të ditur se ka pasur në trajtim amendamentin me qëllim të përfshirjes së Konventës në Kushtetutën e Kosovës dhe e ka aprovuar si të tillë. Janë 82 deputetë që e kanë nënshkruar këtë amendament. Ditë më parë, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Philip Kosnett, u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës që të ratifikojnë Konventën e Stambollit, pasi siç tha ai "nëse Kosova e



merr këtë hap, udhëheqësit dërgojnë mesazh të fuqishëm se Kosova po përgatitet për integrimin euroatlantik". Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje, në një bisedë për Radion "Evropa e Lirë" tha se në secën e radhës, në rend ditë është votimit i amendamentit

me qëllim të përfshirjes së Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës. Haxhiu tha se Konventa e Stambollit për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje është në vazhden e mekanizmeve të cilat po tentohet të aplikohen në Kosovë, për shkak të rasteve të shumta të dhunës në familje dhe vrasjeve të grave dhe vajzave që po ndodhin në vend. Por, sipas saj, nuk mjafton vetëm ratifikimi dhe miratimi, por derisa institucionet kanë probleme me zbatueshmërinë e ligjeve. Parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve janë bazamenti i Konventës së Stambollit. Kjo Konventë e njeh dhunën ndaj

grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi, kjo do të thotë që shtetet kanë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjen në mënyrën e duhur kësaj dhune. Vitin e kaluar, në Kosovë janë raportuar mbi 1,000 raste të dhunës në familje, ndërsa pjesa më e madhe e viktimave kanë qenë gra. Radio "Evropa e Lirë" pati raportuar disa herë për raste të dhunës në familje. Bukuria (emri i njohur për redaksinë) ishte një nga viktimat e dhunës në familje. Ajo kishte deklaruar se bashkëshorti i saj e karrruar vazhdimisht, atë dhe tre fëmijët që i kishin së bashku. Bukuria kishte deklaruar se e kishte njoftuar disa herë policinë për dhunën që po ushtrohej ndaj saj nga burri, duke treguar po

ashtu, se ai arrestohej, por zakonisht lirohej pas 48 orësh. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje u hap për nënshkrim në vitin 2011, në Stamboll të Turqisë. Turqia ishte vendi i parë që ka ratifikuar këtë Konventë. Deri më tani kjo Konventë është nënshkruar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk është nënshkruar e kësaj Konvente dhe e vetmja që nuk është pjesë e Këshillit të Evropës, një prej organizatave më të rëndësishme në Evropë.



**Greqia "vend" destinacioni për fëmijët, viktimat trafikimi**

Miliona fëmijë çdo vit nga 127 vende të botës janë viktimat e trafikimit me qëllim të nxjerrjes së tyre në prostitucion ose punë të zezë në 137 vende, ndërsa UNICEF raporton se dy milionë fëmijë detyrohen në prostitucion çdo vit. Këto të dhëna u paraqitën nga Profesor i Departamentit të Mjekësisë, psikiatër dhe seksolog Loukas Athanasiadis, në Konferencën e Fëmijëve dhe të Gjinekologjisë Adolleshente mbajtur në Selanik. Athanasiadis tha se: "Viktimat e trafikimit për shfrytëzim seksual erdhën nga 127 vende dhe janë duke u promovuar në 137 vende. Greqia nuk është më një vend i ndërmjetëm, por një vend destinacioni. Ne po flasim për refugjatët nga jugu. Keni dëgjuar nga institucionet në Greqi se fëmijët dhe adoleshentët janë zhdukur misteriozisht dhe nuk janë gjetur. Sigurisht që mund të supozojmë se ku kanë përfunduar ata. Refugjatët sot janë një problem i madh, sepse ndër të tjera, fëmijët dhe adoleshentët bëhen viktimat e abuzimit. Ka shumë fëmijë të pashoqëruar dhe shpesh "kujdëstarët" e tyre janë promotorë. Në të njëjtën kohë, trafikimi është fitimprurës, pasi ata që "shesin" fëmijët dhe adoleshentët fitojnë më shumë para se ata që shesin armë. Është, gjithashtu, një aktivitet me rrezik të ulët, të dhënat janë të pamjaftueshme, disa janë arrestuar dhe operacionet e shërbimit ndoshta janë të pamjaftueshme. Pasoja janë jashtëzakonisht serioze për shëndetin fizik, seksual dhe mendor të viktimave të fëmijëve dhe adoleshentëve", shtoi Athanasiadis.

Presidenti serb konfirmon pjesëmarrjen në Samitin e Ballkanit më 29 prill

# Dialogu Kosovë-Serbi, Haradinaj e Thaçi takohen në Berlin me Vuçiç

*Franca dhe Gjermania, iniciatorët e takimit në fundprill*

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj do takohen me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç në Berlin. Lajmin e ka konfirmuar vetë Vuçiç djë në një konferencë për mediat. Presidenti serb ka treguar se ky takim është caktuar që të mbahet me 29 prill, dhe në të do të jetë e ftuar edhe kryeministria serbe, Ana Brnabić. Nga ana tjetër, këshilltari i presidentit, Bekim Çollaku ka konfirmuar se presidenti Hashim Thaçi ka marrë ftesë për këtë takim të liderëve të Ballkanit Perëndimor në kryeqytetin gjerman. "Po e konfirmoj pranimin e ftesës për Presidentin e Republikës së Kosovës për pjesëmarrje në takimin e liderëve të Ballkanit Perëndimor që mbahet në Berlin më 29 prill", ka thënë Çollaku. Ky takim është bërë me nisjen e Francës dhe Gjermanisë dhe pritet të diskutohet rreth situatës aktuale së bllokimit të dialogut si dhe gjetjen e një gjuhe të përbashkët për të ecur përpara. Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë është pezull që pas vendosjes së taksës për produktet serbe nga qeveria kosovare. Disa ditë më parë ndërkaq është diskutuar për dialogun Kosovë-Serbi dhe kufirin e shumëpërfolur për t'u ndryshuar. "Çështja e kufirit mes Kosovës e Serbisë, nuk është në qendër të marrëveshjes", deklarata vjen nga zëvendës ndihmës sekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, gjatë bashkëbisedimit me gazetaret në Tiranë. Palmer tha se SHBA mbështet Kosovën, ndërsa kërkoi nga Serbia ta njohë atë si shtet të pavarur e sovran. Gjithashtu, zyrtari amerikan theksoi se inkurajon palët në finalizimin e marrëveshjes me dy shteteve. "E vërteta është që, si SHBA dhe Gjermania e



mbështesin Kosovën. SHBA nuk mbështet një rezultat të caktuar të procesit të negociatave; ajo që mbështesim është jetë marrëveshje midis Beogradit dhe Prishtinës që sigurojnë normalizimin e plotë të marrëdhënies midis Serbisë dhe Kosovës. Besojmë që elementet qendrorë i kësaj duhet të jetë njohja e ndërsjellë, pra që Serbia njeh Kosovën si vend sovran dhe i pavarur dhe Kosova njeh Serbinë në të njëjtën mënyrë. Dhe mbi bazën e kësaj, të dy vendet e pavarura punojnë për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Çdo marrëveshje për normalizim të marrëdhënies është shumëdimensionale; do të ketë një element politik, një element sigurie, një element ekonomik dhe tregtar, do të ketë edhe një element kulturor që do të marrë parasy-

sh statusin e pronave të Kishës Ortodokse në Kosovë. Çështja e kufijve mund po ashtu të jetë pjesë e kësaj, por nuk është elementi kryesor i marrëveshjes sado që ta imagjinojmë këtë. Ajo që është e rëndësishme për SHBA është që, çfarëdo marrëveshjeje të ketë pronësi vendase, të jetë diçka që të dyja palët ndjejnë se mund ta mbështesin, të dyja palët ndjejnë se mund ta shesin, të dyja palët besojnë se mbron interesat e tyre thelbësore, dhe ajo që kemi bërë në është që i kemi nxitur palët të ulen në tryezë dhe të negociojnë marrëveshjen më të mirë që mundën. Për aq sa SHBA është gati ta mbështesë atë marrëveshjeje, ne duam të na e sjellin, të na e tregojnë, ta shohim se çfarë është. Nëse kemi shqetësime

### Maqedonia e Veriut, në javën e dytë të fushatës

Fushata për zgjedhjet presidenciale, tre kandidatët shpалosin platformat përkatëse

Tashmë Maqedonia e Veriut ka hyrë në javën e dytë të fushatës presidenciale. Kandidatët për kreun e vendit janë duke shpалosur konceptet e tyre para qytetarëve. Integrimet euroatlantike, lufta kundër korrupsionit dhe ndalimi i migrimit masiv janë temat që përdoren gati në çdo fushatë. "Zotëria në fjalë, për të cilin mendoj se nuk është president, por pushtues i atij funksioni, nuk e pranon emrin kushtetues të vendit të tij, dhe në të gjitha dekretet që i ka nënshkruar deri tani përdor emrin e vjetër kushtetues", thotë kandidati i koalicionit qeveritar. Njohësit e rrethanave politike thonë se fushata e deritashme ka qenë demokratike, ku kandidatët kanë patur një nivel të respektimit të ndërsjellë. Por kjo nuk mund të thuhet për mediat online. Ndërkohë, Misioni i OSBE/ODIHR-it ka publikuar raportin periodik ku në këtë dokument thuhet se kandidatët para shpalljes zyrtare të kandidaturës, kanë qenë të kycur në aktivitetet zgjedhore. OSBE-ja, gjithashtu, vëren se gratë shumë pak janë të përfaqësuar në jetën publike.



për të, do t'i artikulojmë ato shqetësime dhe do të shohim nëse mund të gjejmë mënyra për t'i kapërcyer, por nuk po

mbështesim ndonjë rezultat të caktuar apo ndonjë pjesë të caktuar përbërëse të asaj që, me përkufizim, do të ish-

te një diskutim i gjithanshëm, një marrëveshjeje e gjithanshme. E mbështesim këtë proces, mbështesim EEAS dhe BE në drejtimin e këtij procesi; nuk jemi palë në negociatë por jemi palë në kuptimin që kemi interes në rezultatin e tyre pozitiv. Duam një zgjidhje që hap një rrugë europiane, një të ardhme europiane si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën, dhe jemi të përkushtuar që në partneritet me autoritetet në Kosovë si dhe me qeverinë në Serbi ta çojmë përpara atë synim." - u shpreh Palmer, në përgjigje të gazetareve.



"Të drejtat dhe zgjedhjet për të gjithë", punë e pambaruar e shoqërisë

Nga Alanna Armitage

Pas tri dekadash, pothuaj një gjeneratë, pasi vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore dolën nga kolapsi i Komunizmit dhe nisën rrugën e ekonomisë së tregut dhe demokracisë, rajoni është tashmë në mes të një revolucioni të një lloji tjetër. Unë do ta quaja revolucionin i zgjedhjes. Zgjedhja ndodh kur njerëzit kanë mundësi të marrin vendime për jetën e tyre. Kjo fillon me pyetjet më bazike: Me kë dua të jem? A dua të kem fëmijë? Sa fëmijë? Çfarë pune dua të bëj? Për çfarë arsimimi kam nevojë? Çfarë balance dua midis jetës private familjare dhe punës apo aspiratave të tjera? Kur njerëzit i bëjnë këto zgjedhje lirish, ata përparojnë. Zgjedhja është fuqizim. Dhe e shohim zgjedhjen të lulëzojë kudo në rajon, kur gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat i përdorin mundësitë që ofron bota jonë në ndryshim për të formësuar jetën e tyre dhe për të ndjekur të ardhmen që duan. Por jo të gjithë përfitojnë në mënyrë të barabartë. Në fakt, shumica e shoqërisë është ende e përjashtuar nga revolucioni i zgjedhjes. Për shembull Maria nga Moldova. Maria ishte 16 vjeç kur mbeti shtatzënë për herë të parë. Ajo nuk dinte asgjë për kontracepsionin apo rrezikun nga një shtatzëni e hershme. "Unë nuk i kisha diskutuar kurrë këto gjëra me nënën time. Më vinte turp", na tha. "Edhe mësuësës së biologjisë i vinte turp, mendoj, ndaj i shmangte këto tema." Maria e la shkollën, megjithëse kishte qenë midis nxënësve për jetën e tyre: lindja e një fëmije në moshë të hershme, shpesh duke i dhënë fund arsimimit dhe i duke çuar drejt një jete ku mbizotëron varfëria dhe dhuna. Miliona gra kanë rënë në kurthin e marrëdhënieve të pabarabarta ose abuzive. Atyre nuk u lejohet të marrin vendime për trupin, shëndetin apo fertilitetin e tyre, por jetojnë nën një frikë konstante dhune. Në mënyrë shqetësuese, një në tre gra në rajonin tonë ka provuar një formë të dhunës fizike ose seksuale, shpesh nga një partner, tregon studimi i fundit i mbështetur nga UNFPA. Këto nuk janë thjesht statistika. Çdo vajzë që braktis shkollën, çdo grua që rrihet apo mbyllet në shtëpi do

# UNFPA: Një në tri gra, e dhunuar fizikisht dhe seksualisht

Armitage: Të ndihmojmë njerëzit që të kenë zgjedhje të lirë



të thotë një jetë tjetër në rrezik serioz për të mos realizuar potencialin e vet. Si shoqëri moderne ne nuk mund ta përballojmë humbjen e potencialeve apo talenteve të miliona njerëzve që hasin përjashtim dhe diskriminim: gra dhe të rinj, persona me aftësi të kufizuara, emigrantë, minoritetet, të moshuar dhe grupe të tjera që shtyen në qoshe. Ky nuk është thjesht moral i domosdoshëm. Ai shkon në zemër të mundësisë së një vendi për t'u drejtuar drejt stabilitetit dhe prosperitetit afatgjatë. Lajmi i mirë është se ka shenja ndryshimi kudo. Prindërit po fillojnë të shohin vlerën e asaj nëse i japin fëmijëve të tyre atë për të cilën kanë nevojë që të bëjnë zgjedhjet e tyre të shëndetshme dhe të sigurta edhe, nëse kjo përfshin tema të tilla të parehatshme si seksualiteti. Shumë të rinj po dalin në ballë dhe po angazhohen në formimin e të ardhmes së tyre dhe atë të vendeve të tyre. Gjithnjë e më shumë burra po kuptojnë se rolet tradicionale gjinore jo vetëm dëmtojnë gratë, por minimizojnë eksperiencën e tyre si partnerë dhe baballarë. Njerëzit po kuptojnë se diferencat - qofshin gjinore, moshore apo aftësi fizike - nuk ndikojnë në vlerën dhe dinjitetin e brendshëm të jetës njerëzore. Këto transformime shohin në opinionin e fuqishëm të ndryshimit. Ato na sjellin më afër realizimit të vizionit të formuluar 25 vite më parë, në themelet e Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICPD), e cila vuri të drejtat dhe zgjedhjet e individit në zemër të axhendës

### 10 VIKTIMA NGA PËRMBYTTJET, 9 ORË SHI SA PËR NJË MUAJ

Pasojat e motit të keq që ka mbërthyer orët e fundit Rio de Zhaneiron janë fatale për jetën e disa njerëzve. Të paktën 10 persona humbën jetën nga rrebeshi që i gjeti autoritetet dhe banorët të papërgatitur. Ujërat e furishëm vërshuan ngado nëpër rrugë e banesa. Autoritetet lokale shpallën gjendjen e emergjencës. Sipas tyre, niveli i shiut të rënë arriti në 246 mm duke tejkaluar brenda një dite mesataren mujore.

**FOTOLAJM**

ndërkombëtare të zhvillimit dhe theksoi se fuqizimi i grave dhe vajzave është kyç për mirëqenien e individëve, familjeve, kombeve dhe botës. Sot, kur shënojmë 25 vjetorin e ICPD dhe prezantojmë këtë raport të Gjendjes së Popullsisë së Botës "Punë e pambaruar: Në ndjekje të të Drejtave dhe Zgjedhjeve për të Gjithë", ne i bëjmë thirrje qeverive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe individëve të bashkohen me revolucionin e zgjedhjes. Të gjithë ne duhet të bëjmë pjesën tonë për ta bërë zgjedhjen një realitet për këdo - përmes ligjeve dhe politikave, dhe përmes sjelljeve dhe qëndrimeve tona. Disa hapa mund të të çojnë larg. Ofrimi i edukimit për jetesë të shën-

detshme në të gjitha shkollat për shembull. Zbatimi i politikave për zero tolerancë ndaj dhunës kundër grave dhe krijimi i sistemeve për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës. Sigurimi i kujdesit për fëmijët, leja prindërore dhe përllogaritjet fleksibël të punës në mënyrë që asnjë prind të mos detyrohet të zgjedhë midis fëmijëve apo karrierës. Investimi në politika për të zgjeruar zgjedhjet e njerëzve dhe për të mos lënë asnjë pas, forcon atë që shkençtarët e quajnë "kapital njerëzor", aftësitë e kombinuar, njohuritë dhe ekspertencat e popullatare. Kjo gjë është esenciale për performancën ekonomike. Dhe i vendos vendet në një pozicion të fuqishëm për t'u mar-

rë me pasojat e ndryshimit demografik, siç janë niveli i ulët i lindjeve apo moshimi i popullatave. UNFPA, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, ka 50 vjet eksperiencë ndihme për vendet që të hartojnë politika të tilla dhe këshillim bazuar në atë çka ndodhur diku tjetër. Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë vendet e rajonit për të çliruar fuqinë e tyre të plotë të zgjedhjes. Sepse zgjedhja nuk është vetëm një e drejtë që duhet gëzuar nga çdo person. Është një përbërës esencial për të formuar të ardhmen tonë të përbashkët.

Alanna Armitage është Drejtoresha e Zyrës Rajonale të UNFPA për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore.

## SHKURT

### Izrael, koalicioni i Netanyahu fiton zgjedhjet

Kryeministri Benjamin Netanyahu ka marrë një mandat të ri pas numërimit të 97% të votave. Partia "Likud" e Netanyahu dhe partia e ashtuquajtur "Blu e Bardhë" e Benny Gantz kanë marrë nga 35 vende secila si parti. Por koalicioni i djathtë i kryeministrit aktual ka 65 vende nga 120 në dispozicion në Knesser dhe kjo i jep mundësi të ketë një majorancë në qeveri. Në bazë të sondazheve si Gantz dhe Netanyahu e quanin veten fitues.

### Rekord turistik në Francë, pavarësisht grevave të 'jelekëverdheve'

Hoteleria franceze ka qenë e mbushur plot turistë në 2018, një frekuentim rekord që mund të kishte qenë edhe më i lartë nëse nuk do të kishte pasur greva në pranverë në transporte dhe mbi të gjitha ajo e jelekëverdheve, manifestimet e të cilëve prekën hotelierinë në dhjetor, njoftoi sot Instituti Kombëtar i Statistikave (INSEE). "I gjithë sistemi i hotelierisë turistike në vend regjistroi 438,2 milionë net vitin e kaluar, ose nëntë milionë më shumë se sa në 2017", sipas të dhënave të INSEE-së. Instituti vendos theksin mbi një rekord të ri frekuentimi, pavarësisht një viti të shënuar nga lëvizjet sociale kombëtare shumë të mëdha të zhvilluara në dy faza, ku e para ishte ajo në transportet ajrore dhe hekurudhore në tremujorin e dytë dhe më pas ajo e jelekëverdheve duke filluar në mes të nëntorit.

### Fshati i vogël që po përgatitet të bëhet qendra e re e BE-së

Një zhvendosje në zemër të Europës pritet të ndodhë. Zhvendosje kjo që nuk është politike, por gjeografike. Që prej përfshirjes së Kroacisë në BE në vitin 2013, qendra e BE-së ka qenë një qytet i vogël në Bavari, i quajtur Westerngrund. Por gjithçka mund të ndryshojë me daljen e Britanisë së Madhe. Qendra e re e BE pritet të zhvendoset nga Westerngrund në Gadheim. Udhëtimi nga Westerngrund për në lokacionin tjetër bavarez Gadheim zgjat rreth një orë. Qendra gjeografike e BE-së përcaktohet nga Instituti Gjeografik Francez (IGN). Megjithëse ka ndryshuar disa herë pas zgjerimeve të herëpashershme, qendra e BE ka mbetur në Gjermani që prej zgjerimit të 10 vende të reja në vitin 2004.

7 PRILLI 1939

# OLSA ULQINAKU: Çfarë na mësoi stërgjyshi ynë Mujo Ulqinaku

Fatmira Nikolli

Dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare janë jo vetëm simbol i pashlyeshëm i rezistencës kombëtare dhe luftës për liri, por edhe frymëzim për ne brezat e sotëm. Gjaku i derdhur nuk do të shkojë dëm dhe sakrificat do të ketë kuptim, ndaj, na takon ne nipërve dhe mbesave, ne stërnipërve dhe stërmbesave që të ruajmë të freskëta këto mesazhe heroizmi e qëndrësive. Ka qenë ky mesazhi që ka dhënë Olsa Ulqinaku, stërmbesa e Mujo (Cakuli) Ulqinakut në ditët e përkujtimit të pushtimit të Shqipërisë. Teksa më vonë historiani Moikom Zeqo do të shtonte se "procesi i pushtimit të Shqipërisë ishte logjik, sepse fashizmi italian kishte ndërmend që të bënte luftën italo-greke. Ne nxorëm një figurë kundër luftës italo-greke, siç ishte Mujo Ulqinaku. Pushtimi i Shqipërisë është një nga ngjarjet më të diskutuara të shekullit XX. Kishte kontradiktat, nëse do të bëhej ose jo. Pushtimi u bë si një ultimatum ndaj Zogut, për borxhet që kishte. Zogu është një politikan i kompromiseve edhe jo i rezistencës. Nuk rezistoi as në luftën e Vlorës në 1920".

80 vite më parë, Shqipëria ra në duart e fashistëve, e ndonëse ka teori që nuk pati rezistencë, ka historinë e dëshmi që thonë të kundërtën, si humbja e jetëve njerëzore.

Përvjetori i luftës është shënuar nga Muzeu Historik Kombëtar që organizoi aktivitetin "80 vite nga pushtimi fashist italian". Takimi solli ilustrime, fotografi të dëshmorëve të rënë, poezi e komenteve historike. Pasardhësit e Mujo (Cakuli) Ulqinakut, për herë të parë për publikun prezantuan disa fotografi të Mujo Ulqinakut. Aktiviteti në përkujtim të 80-vjetorit të rënies së dëshmorëve gjatë qëndrësës së armatosur kundër agresionit fashist, u mbajt në bashkëpunim me gjimnazin "Petro Nini Luarasi".

Përkujtimi i luftërave heroike në mbrojtje të atdheut nga pushtimi i italianëve fashistë u realizua nëpërmjet pjesëmarrjes së historianit Dr. Moikom Zeqo, drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, interpretimeve dhe referimeve të gjimnazistëve. Në këtë veprimtari ishin të pranishëm dhe të ftuar dashamirës të fushave të ndryshme. Dr. Dorian Koçi, drej-



Olsa Ulqinaku

## Përkujtimi i luftës, flasin historianët e pasardhësit

tori i Muzeut Historik Kombëtar, përveç të tjerash tha se, "ideatori kryesor i pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste ishte konti Galeazzo Ciano, dhëndri i Benito Mussolinit, të cilit i lindi ideja për një "zgjidhje tërësore për Shqipërinë. Është shkruar shumë për këtë... Ndonjëherë duket se disa ngjarje, që ndodhin krijojnë edhe sjellin një hapësirë tjetër të mendimit dhe

diskutimit sa i përket trajtimit të tyre të vendit apo të kombit. Jemi në Pavijonin e Luftës Antifashiste, ku kjo periudhë është pasqyruar... Antifashizmi është një nga vlerat e Evropës së sotme".

Pushtimi fashist italian më 7 prill 1939, ishte një ndër aktet e para agresive të fashizmit në Europë. Luftimet më të përgjakshme u bënë në Durrës, por edhe në Shëngjin, Vlorë e Sarandë. Në Durrës trupat italiane u pritën me zjarr nga Mujo Ulqinaku, Hamit Dollani etj". Dr. Moikom Zeqo bëri një panoramë të zgjeruar sesi erdhi pushtimi fashist në

siç është Kosova. Antifashizmi është një shpikje e shekullit XX të Luftës së Dytë Botërore. Lufta e Parë Botërore nuk ka antifashizëm, nuk ekziston. Krijimi i kësaj kulture ishte që shtetet kundërshtarë ideologjike duhet të ngriheshin edhe të krijonin një aleancë, që nuk ka shembull në 20 shekuj. Kjo aleancë duhet që t'i kundërvijet boshtit të famshëm fashist, në mënyrë të veçantë nazizmit gjerman. Historia e fashizmit italian me nazizmin gjerman ka kontradiktat e veta, por, gjithsesi edhe Mussolini edhe nazistët e filluan pushtimin e Europës me Luftën e Spanjës".

Tetëdhjetë vjet më parë, në të premtën e zezë të 7 Prillit 1939, Shqipëria u sulmua në mënyrën më të pabesë nga Italia Fashiste. Trupat italiane komandoreshin nga gjenerali Alfredo Guzzoni, i cili kishte të gatshme një ushtri prej 40 mijë vetash dhe armatime të shumta. Mëngjesi i 7 Prillit të vitit 1939, shënoi aktin e sulmit ushtarak të Italisë kundër Shqipërisë. Luftimet të përgjakshme u regjistruan në Durrës, por edhe në Shëngjin, Vlorë e Sarandë. Në Durrës trupat italiane u pritën me zjarr nga Mujo Ulqinaku, kapter i marinës dhe nga major Abaz Kupi. Pas disa orësh rezistence e luftimi, qyteti i Durrësit u pushtua. Shqipëria, si gjithë vendet e tjera, do kalonte nga kalvari i Luftës Botërore, por kundërshtimi i pushtimit që në ditët e para do ta radhiste në Aleancën e Madhe Antifashiste, dhe kjo gjë mbetesh një nga vlerat më të pamohueshme në historinë tonë moderne.

### RIKONCEPTIMI

Pavioni i luftës antifashiste do të rikoncepohet, është shprehur Dr. Dorian Koçi, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar gjatë ditës kur u kujtua 80-vjetori i dëshmorëve gjatë qëndrësës së armatosur kundër agresionit fashist. Ai deklaroi se pavijoni i luftës do të pasurohet me fakte dhe artefakte pas restaurimit të muzeut.

Kanë kaluar 15 vite pas rinovimit të pavionit të Luftës Nacional Çlirimtare, por ky pavion ende nuk pasqyron gjithë protagonistët, pasi dokumentet e reja sipas drejtorit të Muzeut Historik Kombëtar, Dorian Koçi duhen përfshirë në të, e kjo do të ndodhë pas rikonceptimit të muzeut, i cili pritet të ndodhë sa më parë.

Krahas dokumenteve të kancelarive evropiane, në këta stenda duhen shtuar edhe fakte të reja dhe artefakte, thekson Koçi.

Përvjetori i luftës është shënuar nga Muzeu Historik Kombëtar që organizoi aktivitetin "80 vite nga pushtimi fashist italian". Takimi solli ilustrime, fotografi të dëshmorëve të rënë, poezi e komenteve historike. Pasardhësit e Mujo (Cakuli) Ulqinakut, për herë të parë për publikun prezantuan disa fotografi të Mujo Ulqinakut



Dorian Koçi



## PREMIERA

Salomeja e Oscar Wilde paraqet mposhtjen e forcave të rendit dhe ligjit nga forcat e dëshirave të paligjshme seksuale. Meqë Britania ndalonte shfaqjen publike të pjesëve teatrore, ku përshkruheshin personazhe nga Bibla, Uajllid e shkroi "Salomé"-në në frëngjisht në vitin 1891

# Erotikë dhe dramë, Yllka Mujo: "Salome" është një sfidë

Fatmira Nikolli

Shfaqja e shkruar nga Oscar Wilde në Teatrin Eksperimental

Regjisori italian: Përmban të gjitha llojet e emocioneve

Salome" është një dramë thellësisht psikologjike. Oscar Wilde ka arritur të ndërtojë personazhe të ndërlikuara dhe komplekse. Gjykohet se "përmes "Salomesë", Oscar Wilde kërkonte të përballte publikun viktorian me seksualitetin e tij...nëpërmjet figurës së Salomesë ai portretizoi "seksin për seks" pa qëllim ose funksion. Salomeja e Oscar Wilde paraqet mposhtjen e forcave të rendit dhe ligjit nga forcat e dëshirave të paligjshme seksuale"-ka thënë kritika.

Tragedia me një akt, "Salome" e Oskar Wilde, ngjitet në skenën e Teatrit Eksperimental "Kujtim Spahivogli" këtë fundjavë. Me regji të Carlo Sciçaluga, në të interpretojnë Ermira Hysaj, Alert Çeloaliaj, Ervin Bejleri, Yllka Mujo, Alesia Xhemalaj, Emiljano Bufazi, Ermir Hoxhaj, Ilija Kaçi, Ismail Shino, Kleivert Ibrahimllari, Marsel Greva, Urim Aliaj.

Para mediave, aktori Alert Çeloaliaj tha se "jemi në pozita pune e kërkimore se kjo është një pikë ujë në prurjet e mëdha të TKE. Vepra ka një tufë skandalesh brenda, për thellësinë që ka dhe shtrësat e shumta që ka publiku duhet ta shohë 3-4 herë".

Ndërkaq, aktorja Yllka Mujo e përshkroi si "është vepër poetike me tone të fuqishme dramatike, që sigurisht e bën të jetë sfidë për aktorët". Ajo tha se "Jam e kënaqur që teatri kërkon sfida të fuqishme për ato që sjell në skenë. Kjo i jep teatrit energjinë dhe frymën që i duhet teatrit. Këtu po bëhet sfida e një teatri të vërtetë dhe kjo i vë aktorët para një presioni të madh, se sfida është me veten: deri ku mund të shkojë aktori, sa mund të eksplorojë te vetja e sa mund të japë nga vetja. Unë jam kënaqur për këtë arsye. Shikoj mes stafit dashuri, dashuri që e ndihmon veprën dhe e thellon më tepër. Shfaqja është e fuqishme, shpresoj që ta kënaqim publikun. Besoj plotësisht se pas saj do të jenë të impresionuar".

Në vijim regjisori Carlo Sciçaluga u shpreh se "është hera e tretë që vij këtu e çdo herë është gëzim dhe jam në një shoqëri të mirë, sepse kam aktorë nga më të mirët të më të mirët". E cilësoi një tekst të çuditshëm dhe shumë interesant, që është shkruar jashtë kohës së tij, tekstin e veprës. "Ka ironinë e ndjeshmërinë e Oscar Wilde të 1800-ës, por elementet janë të tragjedisve greke. E bukur është



se vihen në lëvizje ndjenjat pasore dhe është një histori me shumë pasion, nëse duam ta themi, edhe një lloj trilleri me pjesë erotike dhe vë në lojë të gjitha emocionet".


Gjatë konferencës, aktorët thanë se vepra sjell për publikun emocione tronditëse edhe rrëqethëse, të cilat janë fryt i një pasioni të pazakontë. Salome (Ermira Hysaj), Princesha e Judese, vajza e mbretëreshës Herodia (Yllka Mujo), gruaja e mbretit Herod (Alert Çeloaliaj) janë të gjithë bashkë në skenë për të përcjellë të gjitha ngjyrat e emocioneve njerëzore.

Për herë të parë për këtë vepër në skenën e këtij teatri nën regjinë e Carlo Sciçaluga-s ngjitet aktorja Yllka Mujo, e cila luan rolin e

mbretëreshës. Ndërsa, nën petkun e Salomes do të jetë aktorja Ermira Hysaj.

Koncepti i regjisorit italian është përtej asaj që shkruhet. Regjisori na rrëfen se ka këmbëngulur tek ajo, çka realisht Oskar Wilde, i cili e ka shkruar këtë vet për në vitin 1891 do të dëshironte që të përcillej tek publiku.

"Për këtë vepër është dashur shumë bashkëpunim me aktorët, sepse emocionet janë shumë të forta këtu dhe duhet një motiv i rëndësishëm që kjo vepër të ngjitet në skenë. Gjuha është shumë poetike, edhe është shumë e vështirë nga ana teknike për aktorët. Unë nuk jam një regjisor modern, edhe pse jam vetëm 31 vjeç. Jam përpjekur që të kuptoj atë që do të donte që të shkruante vërtet autori, jo atë që



shkruhet", tha më tej regjisori Carlo Sciçaluga.

Vepra do të ngjitet në datë 14 prill në skenën e Teatrit Eksperimental "Kujtim Spahivogli". Për herë të parë është ngjitur në skenën në gjuhën në të cilën është shkruar, në frëngjisht. Ndërsa për herë të parë për publikun britanik është shfaqur në vitin 1918, disa vjet pas ndarjes nga jeta të Oskar Wilde.

## VEPRA

"Salomé" është tragjedi me një akt, shkruar nga Oskar Uajllid dhe bazohet lirish mbi historinë biblike, ashtu siç është treguar në librat e Dhiatës së Vjetër. Marku 6:15-29 dhe Mateu 14:1-12, edhe pse karakteri i Salomesë nuk përmentet me emër në Bibël. Vepra vendoset gjatë periudhës biblike në Judë, një zonë historike, me shtirje në Lindjen e Mesme, pranë së cilës sot ndodhen Palestina dhe Izraeli. Salomé është thjesht e mbretit Herod Antipas të Judesë. Ai është bashkëshort i Herodias, e cila është e mallkuar nga një

profet me emrin Jokanaan (i njohur në Bibël si Gjon Pagëzori). Ky thotë se martesë e Herodit është e paligjshme, sepse Herodias është vejusha e vëllait të Herodit. Në Bibël, Salomé e ndihmon të ëmën të marrë hak ndaj Gjon Pagëzorit, ndërsa në veprën e Uajllidit vendimet e Salomesë ndaj Jokanaanit vijnë si rezultat i dëshirës së saj për hakmarrje nga epsi. Për tmerrin e mbretit dhe për gëzimin e së ëmës, Salomé kërkon kokën e Jokanaanit në një pjatë argjendi, si shpërblim për vallen e shtatë vellove, që ajo do të kërcëjë para mbretit Herod. Për arsye se ligji britanik i kohës ndalonte shfaqjen publike të pjesëve teatrore, ku përshkruheshin personazhe nga Bibla, Uajllid e shkroi "Salomé"-në në frëngjisht në vitin 1891. Ajo u shfaq së pari si një pjesë teatrore në frëngjisht. Tre vjet më vonë u botua një version i saj në anglisht. Për publikun britanik u shfaq për herë të parë në vitin 1918, disa vjet pas vdekjes së Oskar Uajllidit.

Opinion

i Ditës

# Përse Shqipërisë i është cenuar siguria kombëtare?

Nga Blendi Fevziu

(vijon nga faqja 1)

... e të cilave nuk dihet ende e nuk bëhet publike; nuk bëhet fjalë që ngjarja përsëritet identik dy vite më pas dhe vjedhja ndodh sërish brenda pistës së aeroportit; nuk është kaq i rëndë fakti që protagonist është i njëjti person, i dënuar edhe për dy vjedhje të mëparshme; as fakti që në kërkim policor si një person shumë i rrezikshëm ai vërtitet lirshëm në zonën e aeroportit dhe në periferitë e Tiranës; as që kishte informacion tejet të saktë për transfertat e valutës e me siguri edhe për shumat që transportoheshin; as për faktin që i gjithë operacioni i mirëmbledhur dhe me shumë impajm financiar dhe logjistik ishte organizuar pa rrjedhur asnjë informacion tek policia, shërbimi informativ apo strukturat e tjera të sigurisë; as për faktin që vjedhja në vetvete ngjante më shumë me një prej filmave më të sofistikuar të Hollivudit.

Jo.

Të gjitha këto janë tejet të rëndësishme dhe duhen analizuar një nga një. Por ngjarja është shumë më e rëndë, madje më e rënda e viteve të fundit për një tjetër arsye. Shqipërisë nuk i janë vjedhur 7, 8, 10 apo 12 milionë euro. Shqipërisë i është cenuar deri në themel siguria e saj. I ka rënë ose ka falimentuar siguria e një prej vendeve më të kontrolluara dhe të sigurta, aeroportit. Aeroporti i një vendi anëtar të NATOS, aeroporti civil e njëkohësisht ushtarak, ku ndodhet Komanda e Forcave Ajrore, është thyer me lehtësinë më të madhe nga pesë banditë.



Banda ka pasur synim vjedhjen e valutës, por ajo mund të kishte bërë çfarë të donte. Mund të kishte marrë peng avionin ku tashmë qenë ulur 160 pasagjerë, mund ta kishte hedhur atë në erë, mund të kishte marrë peng presidentin e vendit që u kthye nga Danimarka me po atë avion, apo ndonjë zyrtar të lartë amerikan që udhëtonte pak më vonë. Nëse në vend të hajdutëve

do të kishin qenë 4 terroristë, Shqipëria do ishte sot në faqet e para të gjithë shtypit botëror, duke bërë lajmin më të keq për të. Dhe kjo ndodh në aeroport. Në një prej vendeve të sigurisë më të lartë! Të rralla janë vendet në botë, që kanë një siguri të tillë. Më ka qëlluar të udhëtoj në aeroporte të izoluar e të vegjël afrikane, aziatike apo të Amerikës qendrore, por siguria e

aeroporteve është një çështje jashtë çdo diskutimi. Pas sulmeve mbi kullat binjake dhe Pentagonin më 11 Shtator 2001, e gjithë bota ka investuar shumë në sigurinë e aeroportëve dhe në kontrollin e tyre. Shqipëria jo! Ndaj them që Shqipërisë i është cenuar siguria kombëtare.

Siguria e aeroportit nuk është vetëm detyrë e shoqërisë konce-

sionare. Më 2 shkurt 2011, qeveria shqiptare ka ngritur një Komitet Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, i cili është i ngarkuar edhe për sigurinë e Aeroportit Nënë Tereza. Komiteti ka për Kryetar Drejtorin e Autoritetit civil dhe nënkryetar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Anëtarë të tij janë Drejtori i Doganave, Drejtori i Kufirit, Shefi ushtarak i forcave ajrore, Drejtori i Emergjencave Civile, Drejtori i ANTA dhe shumë e shumë zyrtarë të tjerë të lartë. Komiteti mbledhur çdo tre muaj, por asnjë dokument nuk vërteton dot se kur është mbledhur për herë të fundit ky komitet.

E gjithë kjo shpurrë zyrtarësh të lartë të sigurisë duhej të kishte vënë re që koncesionari nuk i respektonte detyrat e veta. Siç mund të konstatonte që nga vjedhja e parë që objekti ndoshta më i rëndësishëm në vend ishte lehtësisht i depërtueshëm dhe i pambrojtur. Pra, pa asnjë diskutim, shteti ka falimentuar i gjithi, bashkë me koncesionarin që në gjithë këto vite s'e ka fshehur kurrë arrogancën e tij. Arrogancë që nuk dihet nga buron.

Ndaj në Rinas nuk janë vjedhur thjeshtë disa milionë dollarë. Në Rinas ka rënë siguria kombëtare e Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë një goditje fatale besimi i partnerëve tek ne. Një ngjarje që me siguri do ngelet sërish pa përgjegjës, si gjithnjë në një vend ku ndëshkohet me të drejtë një shitës që shet pa kupon tatimor dhe falen pa të drejtë dhe në mënyrë flagrante zyrtarë që janë përgjegjës për humbjen e milionave dhe centimin e sigurisë së vendit.

Kjo është realisht fatkeqësi.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE  
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE  
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ





Opinion i Ditës

# Lleshi, gjenerali i policisë së vdekur

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... i është përgjigjur në mënyrën më të shëmtuar të mundshme. Në vend që të dilte me përunjësi dhe me ndjenjë përgjegjësie përpara shqiptarëve, ai ka bërë një enumeracion faktesh dhe insinuatash që mëtonin të shënjestronin koncesionarin e aeroportit.

Duhet thënë që një fillim se Sandër Lleshaj nuk është përgjegjës për këtë strategji. Që prej 24 orësh, kjo larje duarsh nga faji është vendosur në zyrat e spin doctors-ave të Ramës, filozofia e të cilëve tashmë është e njohur: "sa herë ke një hall, shpall një armik". Sipas kësaj sjelljeje ministria e linjës u detyrua të bënte një deklaratë që nga Berlioni, ku damkoste me tone të ashpra kompaninë kin-eze.

Edhe Sandër Lleshaj nuk bëri asgjë më tepër. Gjenerali u soll njësoj si ato velinat që i nxjerrin në tribunat e partive për të recituar tekstet e hartuara më parë në zyrat e liderëve. Me një fjalor prej demagogu ai ka numëruar paratë që qytetarët i paguajnë koncesionarit, mospërdorimin e tyre për rritjen e sigurisë, dështimin e përbushjes së parametrevave nga kinezët dhe ka premtuar se firmës private këtej e tutje shteti do t'i vërë kufirin tek thana.

Gati, gati të dukej sikur po ta dëgjoje dhe pak do të bindeshe se edhe nëna që e polli Admir Muratja nuk ishte një malësore nga bjeshkët e Tropojës, por një grua nga Azia e largët.

Po ta ndiqje seriozitetin dhe bindjen me të cilën fliste kundër kinezëve mund të harroje të bëje disa pyetje të thjeshta.

Po për Muratja që është prej 6 vitesh i pakapur, policia nuk kishite asnjë faj? A nuk të bën të dyshosh fakti se autori i së paku tre vjedhjeve spektakolare ishte ende i lirë? Po "rastësia" se ai godiste gjithnjë rreth zonës së aeroportit,



a nuk duhet ta shtynte policinë të thellohej në hetimin e këtyre grabitjeve të përsëritura? Po nëse shteti sot krekoset se do të marrë masa kundër kompanisë së aeroportit, a nuk i mjaftuan rastet e mëparshme për ta bërë këtë? Të mendosh se qeveria dhe uniformat blu janë pa faj në ngjarjen që u bë super lajm botëror do të thotë të jesh naiv.

Të besosh pastaj se këtë mund t'ua shesësh shqiptarëve si të vërtetë do të thotë t'i marrësh ata për idiotë.

Pikërisht këtë u përpoq të bëjë Gjenerali Sandër Lleshaj duke u shndërruar në një vegël qorre të spin doctor-save të Ramës.

Por e keqja e kësaj historie nuk qëndron tek manipulimi. Ajo që ka ndodhur është e qartë si drita e diellit dhe nuk ka përlivan që mund ta devijojë.

Këtu problemi është më i madh. Ai qëndron tek transformimi i poli-

icisë së Lleshajt në një trupë që i shërben propagandës politike.

Vetëm pak ditë më parë, pasi opozita provoi me anë të përgjimeve, se një kapter nga Fieri kishte manipuluar një dëshmitar si Albert Veliu, në mënyrë që drejtësia të vërtetonte atë që pati thënë kryeministri për Agron Xhafajn, ai u gradua drejtor policie i këtij qarku.

Po të shkojmë më tej, faktet bëhen edhe më të rënda. Lapsi.al denoncoi para pak kohësh vënien e snajperëve të policisë në shërbim të televizioneve të pushtetit. Atyre që detyra ia do, për arsye sigurie, të ndjekin nga kullat e larta mbi bulevard protestat që zhvillohen aty, shpërndanin në kohë reale imazhet e gurahedhësve nga taraca e PD-së.

Duke u shtuar këtyre edhe dhunën e shproporcionuar në protesta dhe bllokadën që u bëri gazetarëve për të raportuar për ngjarjet e bregut të lumit, nuk është

të vështirë të kuptohet se policia e gjeneral Lleshajt po degradon në një vegël të rëndomtë politike.

Për tu kthyer tek ngjarja e fundit, ku ajo po përdoret sërish si alibi për hallin e Rilindjes, duke krijuar një panoramë të shproporcionuar mes mëkateve të privatit dhe shtetit, e keqja nuk qëndron vetëm tek përpjekja për manipulim.

Por duke dashur ta shfaqësojë policinë, duke u përpjekur ta ekspozojë fajin, Sandër Lleshaj po silllet si një gjeneral që po e vë në gjumë ushtrinë e tij.

Duke nxituar t'i shërbejë Ramës ai po formëson një trupë që nuk lufon me të keqen reale, por me fantazitë oruelliane që shpikin krerët e saj.

Prandaj kur të ndodhë krimi i ardhshëm, mos prisni policë që të ndjekin autorët, por autorë që do jenë duke shpikur fantazinë alibike të radhës.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje nuk rekomandohet të përfshihen nëpër sekrete. Kjo do të krijojë një situatë të sikletshme dhe do t'ju merret kohën e lirë. Do të ishte më mirë të përqendroheshit në punë apo në çështjet familjare.

### DEMI

Demat rrezikojnë të përballen me probleme, pas një mashtrimi të bërë nga ana e tyre. Bëni shumë kujdes gjatë bisedave ditën e sotme. Mos ndani sekrete familjare me të huajt. Jepuni prioritet sporteve dhe aktiviteteve fizike.

### BINJAKET

Disa Binjakë duhet të lënë mbresa të paharueshme tek një person i seksit të kundërt. Ka gjasa që diçka të mos ju shkojë ashtu siç duhet. Ata që janë në kërkim të dashurisë nuk duhet të flirtojnë me persona që janë në një marrëdhënie. Nuk rekomandohet të merrni para borxh.

### GAFORJA

Detyra kryesore për Gaforret sot mund të jetë lufta për pastëri në hapësirën personale. Mos hezitoni të hidhni gjërat që nuk i përdorni më. Kujdesuni për fizikun tuaj. Nuk rekomandohet të qëndroni gjatë në shtat apo të kaloni shumë kohë para televizorit.

### LUANI

Luanët duhet të tregojnë zgjuarsi dhe takt me këdo në komunikim. Ka gjasa që këta persona do t'ju mbështesin në zgjidhjen e disa çështjeve serioze. Ka gjasa që të tundoheni të flirtoni me dikë, por bëni kujdes, pasi për të martuarit e kësaj shenje kjo është shumë e rrezikshme.

### VIRGJERESHA

Mbari veten nën kontroll dhe shmangni inatit. Nëse do të kenë dëshirë dhe vullnet, mund të arrihen fitore të mëdha në marrëdhëniet personale dhe në punët e shtetit. Ata që merren me biznes rekomandohen të mos braktisin idetë e tyre. Mbrojtëren mund ta kaloni vetëm duke u rreksuar.

### PESHORJA

Peshoret sot do të tregohen mjaft të kufizuar dhe fjalëpak. Në punë do të jeni shumë të ngarkuar. Sa u përket financave, do të jenë të kënaqshme. Ndoshta këto para do të vijnë nga shiqa e disa artikujve tuaj. Të martuarit e kësaj shenje mund të mendojnë edhe për zgjerimin e familjes.

### AKREPI

Akrepat do të befasohen nga një dhuratë që do të marrin nga një person i panjohur. Sportet ekstreme apo udhëtimet e lodhshme nuk janë të mirëpritura gjatë kësaj kohe. Në mbërmje do të ndihen të lodhur.

### SHIGJETARI

Disa Shigjetarë do të shijojnë eventet e kësaj dite. Në marrëdhëniet personale gjithçka do të shkojë mirë. Mund të bashkoheni me një ish-partner/partneres, ose të nisni një marrëdhënie shumë të bukur dashurie.

### BRICJAPI

Bricjapët mund të tregojnë bujari të paprecedentë. Ndoshta mund të shpenzoni një shumë të madhe parash për një dhuratë për një familjarin tuaj. Ka gjasa që një projekt të kërkojë kujdes të veçantë. Në mbërmje do të përballeni me plane të papritura.

### UJORI

Sot mund të bëhëni konfuzë për shkak të sjelljes së dikujt pranë jush. Rekomandohet në fokusoheni në planet për të ardhmen. Ata që janë në kërkim të dashurisë do të ishte e udhës t'i përkushtoheshin partnerit/partneres me të cilin/cilën kanë kaluar një kohë të gjatë.

### PESHQIT

Mund të përballeni me një konflikt me një mik të ngushtë, apo me indiferencën e partnerit/partneres suaj. Mos lejoni pesimizmin t'ju prishtë planet e mirëmbledhura për këtë ditë. Në mbërmje do të jeni në praninë e miqve.

EUROPIANI I PESHËNGRITJES



Qerimaj bronz në shkëputje, Godelli zhgënjen totalish

U duk sikur do të ishte një ditë zhgënjese në Europian, por në të vërtetë Erkand Qerimaj kthehet me medalje bronz nga Batumi i Gjeorgjisë, ku po zhvillohet kompeticioni i rëndësishëm i sportit të shtangës. Por, ky sukses i shkodrinit ishte një triller i vërtetë. Peshëngritësi shqiptar garoi në Bateria B, për peshën deri në 81 kg. Në stilin e shkëputjes u tregua i saktë në të tria provat, fillimisht mbajti lart peshën 155 kg. Në provën e dytë ai ngriti 157 kg, ndërsa në të tretën 159 kg, duke u renditur në vendin e dytë në këtë bateri. Sa i përket stilit të shtytjes, Qerimaj u tregua i saktë vetëm në provën e

parë, duke ngritur 188. Me 347 kg në total, Qerimaj u rendit në vendin e dytë në dygarësh sa i përket Baterisë B. Deri këtu, një garë dinjitoze, por triumfi i tij do të vinte pas garimit në stilin e shkëputjes në Bateria A, ku merrte pjesë edhe peshëngritësi tjetër shqiptar, Daniel Godelli. Ky i fundit dështoi në të tria provat. Ai nuk ngriti dot 160 kg në tentativën e parë. Në të dytën provoi 161 kg, por sërish nuk ia doli, ashtu si në provën e tretë me të njëjtën peshë. Edhe rezultatet e peshëngritësve të tjerë nuk ishin mbresëlënëse, duke i dhënë të drejtën Erkand Qerimaj të ngjitet në podiumin e fituesve nga Bateria B, duke fituar medaljen e bronzit. Nga ana tjetër, Daniel Godelli vlosi Europianin e tij zhgënjës, pasi u tërhoq nga gara në stilin e shtytjes. Sidoqoftë, ai nuk ishte kualifikuar në dygarësh, për shkak se nuk realizoi asnjë provë në shkëputje.

Të kuqtë lënë pas fantazmat, duke mposhtur Skënderbeun 2-0. Kastrioti fiton derbin e mbijetesës



Jeton Selimi

Partizani nuk i lë shteg Kukësit, mbetet në +9

Verilindorët fitojnë ndaj Laçit me supergolin e Limajt

Partizani tregon "dhëmbët" ndaj Skënderbeut! "Demat e Kuq" lënë pas shpine humbjen zhgënjese ndaj Luftëtarit dhe fitojnë përballjen ndaj korçarëve, duke iu përgjigjur Kukësit dhe duke rikthyer epërsinë në +9 në tabelë. Në përballjen e zhvilluar në "Selman Stërmasi", të kuqtë futën në fushë me mentalitetin e duhur dhe që në fillim i diktojnë takimin në kuartratin e Dajsananit. Në minutën e 14-të Rexhepi shënon një gol të bukur me kokë, por kryesori Bajramaj e anulon për faull. Gjithsesi, të zotët e shtëpisë do të shënojnë 12 minuta më pas, kur Belica gjendet në rrugën e topit dhe me fat e çon atë në rrjetë.

Skënderbeu do të kërkojë të barazojë, por nuk ka forcë, ndërsa Partizani do të shënojë edhe golin e nokautit kur në minutën e 52-të, Jasir Asani shënon nga pika e bardhë e penalltisë për rezultatin 2-0. Skënderbeu duket i pafuqishëm për të reaguar, ndërsa djemtë e Gegës administrojnë rezultatin deri në fund, duke siguruar fitoren e 17-të në kampionat. Kukësi ka triumfuar me re-



zultatini minimal 1-0 në transfertën delikate ndaj Laçit falë një perle të Vesel Limajt, i cili nga një distancë e largët lëshoi një silur në trekëndëshin e majtë të Selmanit, duke realizuar një eurogol, që për verilindorët vlen një sukses shumë të rëndësishëm. Ernes Gjoka e nis me fitore aventurën e tij të dytë të Kukësi, fitore që e ngushton diferencën me Partizanin kryesues në 6 pikë dhe vë nën presion të kuqtë, të cilët pas rreth 60 minutash do të luajnë takimin e tyre kundër Skënderbeut në "Selman Stërmasi". Feston dhe Musolli, që pas shtatë muajsh shkel në fund fushën e blerët. Sfida e zhvilluar në Kurbin mes Laçit dhe Kukësit ka qenë e luftuar dhe terreni i rënduar nuk ua ka bërë aspak të lehtë të dyja skuadrave. Gjithsesi, për ta zhbllkuar këtë 90-minutësh që dukej se do të

SUPERLIGA	
JAVA E 28-të	
TË MËRKURËN	
Tirana - Kamza	3-0
Kastrioti - Luftëtari	1-0
Laçi - Kukësi	0-1
Partizani - Skënderbeu	2-0
Flamurtari - Teuta	3-1
RENDITJA	
SKUADRA	N P
Partizani	28 57
Kukësi	28 48
Flamurtari	28 44
Teuta	28 43
Laçi	28 41
Skënderbeu	28 40
Luftëtari	28 34
Tirana	28 33
Kastrioti	28 30
Kamza	28 17

mbijetesën në fund të kampionatit. Në sfidën e luajtur në "Redi Maloku" të Fushë-Krujës, vendimtare ka qenë minuta e 26-të, kur të zotët e shtëpisë do të fitojnë një 11-metërs. Ka qenë një dalje e gabuar e Ruçit në kufijtë e zonës së rreptësisë, me portierin e bluzinive që ndërhyr ndaj brazilianit Roxher. Për kryesorin Jorgji nuk ka dyshime, penalti dhe nga pika e bardhë ekzekuton saktë Herald Marku. Luftëtari do të kërkojë barazimin, por pavarësisht mundësive, nuk do t'ia arrijë. Ky sukses e çon Kastriotin në 30 pikë, 3 më pak sesa Tirana, e cila dje mori fitoren 3-0 në tavolinë, pasi në kalendar duhet të përballje me Kamzën, ndërsa Luftëtari mbetet në kuotën e 34 pikëve. Klasifikimi premtor betejë deri në javën e fundit se cila skuadër do të mbijetojë.

HABIT KAMERUNASI

Eto'o: Barcelona fitonte prej meje, jo prej Mesit

Ish-futbollisti i Barcelonës ka folur për aventurën e tij gjatë kohës që ishte pjesë e katalanasve. Kamerunasi në një intervistë për "Beinsports" është shprehur se trajneri Guardiola në atë kohë gaboi, pasi lojtari kryesor ishte ai dhe jo Mesi. "Pep ka kaluar gjithë jetën te Barcelona, por gjatë kohës që unë isha atje, ai nuk kuptoi asgjë. Ai nuk e dinte jetën brenda grupit të futbollistëve. I kam thënë Guardiols se do të më kërkosh falje, pasi unë e bëja Barcelonën të fiton-



te dhe jo Mesi. Barcelona ka fituar nga unë dhe Pep duhet të më kërkojë falje". Sulmuesi, i cili tashmë edhe pse në moshën 38-vjeçare vazhdon të jetë aktiv si profesionist me skuadrën e Katarit. Ai

shtoi se në periudhën 2004-2009, kur aktivizohej me Barcelonën, ishte momenti i tij dhe Mesi ende nuk ishte më i miri. "Kjo ishte situata në atë kohë, Mesi do të bëhej më i miri më vonë, por ajo ishte koha ime, mund të pyesni për këtë dhe Ksavin, Injestën apo të tjerë", tha Samuel Eto'o. Në fund, kamerunasi shtoi se ishte Guardiola, ai që e nxori në merkato, megjithatë në fund gjithçka shkoi mirë teksa fitoi tripletetin si protagonist me Interin.

Nuk është më një sekret, Interi është duke u përgatitur për një revolucion në fund të këtij sezoni. Nëse Luciano Spalieti do të largohet pas 2 sezoneve në krye të ekipit zikaltër, as kjo nuk ka shumë dyshime. Antonio Conte është i preferuari i parë i Marotas, një lëvizje kjo, e cila ka marrë edhe bekimin e presidentit Zhang. Ish-trajneri i Çelsit është favorit në raport me Murinjon, Puketinon e Sarin, tre emra të tjerë që janë përfolur si zëvendësues të mundshëm të Spaletit. Sipas të përditshmes italiane "La Gazzetta dello Sport", Conte do të kërkojë një emër të madh në mesfushë për t'iu bashkuar Naingo-

Gjithnjë, nëse ikën Spaleti


Revolucioni i Kontes, ja si do jetë Interi i ri

lan. Me skemën e tij të preferuar 3-5-2, "Gazzetta" është përpjekur të krijojë një ide se si mund të jetë Interi në drejtimin e tij. Në mbrojtje përveç Godin, i cili është prenotuar prej kohësh, nuk është e nevojshme të ketë përforcime të tjera. Në mesfushë ndryshon diskutimi, pasi përveç Naingolon, të cilin e kërkoi me insistim edhe kur ishte në krye të Çelsit, duhet me patjetër një "top-play" për të formuar treshen së bashku me

Brozović. Për këtë vend janë në garë Rakitić, Gyndogan, Eriksen dhe Barreila. Në sulm, Conte nuk do të ishte kundër nëse Ikardi largohet dhe me paratë e fituara nga shitja e tij, do të provojë të gjejë një tjetër bomber. Lukaku është në majën e listës së dëshira, një preferencë e hershme e Interit, alternativa mbetet Xeko e Zapata. I pashmangshëm duket largimi i Perisic, gati duket zëvendësuesi i tij, Bergvijn i PSV.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- U shkrua nga Zweig.
- Fillojnë aksionin.
- Janë për t'u krentuar.
- Sejđini i tarrinerëve.
- Ai i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
- Ekstrema në tunel.
- I ka tek vrapit.
- Fillojnë andej.
- Nuk tregohet nga i pasigurti.
- Luftojnë me pagesë.
- Inicialet e Gere aktor.
- Sirena që i dha emrin Napolit.
- Gjysmë fejesë.
- E ka simbolin Co një i tillë.
- Inicialet e Kazan, regjisor.
- Turner aktore.
- Në radhë të parë.
- As unë as ti.

- Janë galeri në rrugë.
- Gibson aktor.
- Ritet pa zë.
- Është edhe ajo e futbollit.
- Një studio... skulptori.
- Janë fushat pa fund në veri të Orinos.
- Fund shkurti.
- Fillojnë ideologjinë.
- Është materia e trurit.
- Një është atleti
- Është ajo që i ka lënë pas të gjithë.

**VERTIKAL**

- Është edhe ajo epizootike.
- Një është edhe Korabi.
- I këni në dorë.
- Është mbulesë mbi... hambar.
- Kufijtë e kujtesës.
- Janë tek në faqe.
- Kështu përfundon Loreley.
- Një vend nisjeje.
- Në këtë moment.
- Në krye të artistëve.
- Robbins aktor.
- Ai i Hekurt ishte Bismarck.
- Qërohen me... llogari.
- U shkrua nga Kundera.
- Është dhuna me fjalë.
- Yoko e John Lennon.
- Një vepër... taumaturgu.
- Është dhuna me fjalë.
- Është dhuna me fjalë.
- Është edhe ajo gjeografike.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishin formacionet e famshme maqedonase.
- Është e zakonshme për pushime
- Emil piktor.
- Një planet i Kuq.
- Një garë në hipodrom.
- Me të nxjerrin një litër.
- Qorre pa qe.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Është trofe sportiv.
- U hahen... të martuarve.
- Kufizojnë një truk.
- Kërcimi i Zorba Grekut.
- Mund të jenë kohore.
- Kardashian, aktore dhe modele.
- Janë përmasa.
- Është pjesë e gjuhës.
- Nafta e Shell.
- Një i dhjetë në vit.
- Letra pa zë.
- Janë qederet, dëmet.
- Ishin kundërshtarë të babilonasve.
- Është llon papagalli.
- Tregon çmimin me... mirësjellje.
- Fillojnë ndeshjet.

**VERTIKAL**


- Në parat në stadium.
- Është vjelje me... drapër.
- Opera e Verdi-t.
- Qe një markë makine.
- Inicialet e Asimov.
- Ta... ktheni së prapthi.
- Një version i FIAT.
- Është çelësi.
- Është si sobë.
- Një pjesë e makinacioneve.
- Vrau Hektorin.
- Roth aktor
- Qe piktor i famshëm italian.
- Janë vjedhës.
- Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
- Një çiklist në velodrom.
- Është e ardhur nga firmat piramidale.
- Pak diktaturë.
- Një mund të jetë me... ku-ku.
- Nota e diapazonit.
- Masin lëngje të tilla.
- Janë forma.
- I vidhet ustait.
- Është pjesë telefilimi.
- Pikas pa ekstreme.
- Është ëmbëlsirë me qiri.
- Umberto poet italian.
- Dy asa.
- Kollet por jo kot.
- Radiotelevizioni i Kosovës.
- Inicialet e Delon.
- Fillojnë afërsisht.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7									6
		6						5	
2	3		5						
		8			1				5
	5								1
		7	6	8					
6		9	2						
			3						4
					4	3			8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

6	3	1	4	2	8	5	7	9
8	2	4	7	9	5	1	3	6
5	7	9	3	1	6	8	4	2
9	1	6	8	7	3	2	5	4
7	4	3	2	5	9	6	8	1
2	5	8	1	6	4	3	9	7
3	6	7	9	8	1	4	2	5
4	9	5	6	3	2	7	1	8
1	8	2	5	4	7	9	6	3

*Argëtim filozofik*

- Është lakmi të flasësh për çdo gjë dhe të mos duash të dëgjosh për asgjë.  
- Jeta nuk ju jep kurrë siguri ... ju jep vetëm mundësi !!!  
- Kur qeveria çon një popull në shkatërrim nga të gjitha rrugët, revolucioni nuk është më një e drejtë e qytetarëve, por një detyrë.  
- "Fal"... sepse një ditë ju do të kenë nevojë për një falje !!!

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

T	5	4	11	4	1	19	3	13	4	16			
H	1	5	6	3	10	9	3	11	4	13	6		
E	13	7	11	4	19	4	7	2					
S	11	1	5	4	14	15	6	5	3	4			
	7	1	5	1	14	18	1	12	3	2	2		
	15	1	7	1	13	7	3	19	3	1	13	16	
	4	14	1		17	4	14	9	4	7	3	4	
	9	6			5	5	3	11	3		9	19	
	4	5	5	3	1	1	4	12	3	3	5		
	5	1	4	2		16	1	2	2	1	5	16	
	1		18	1	5		4	9	4	14	1	7	3
	7	5	4	13	7	3		4		4	10	3	2

B	A	S	T	E	T	P	A	P	A			
U	R	A	T	U	R	H	P	A				
S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I		
T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T		
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T	
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R		
B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T		
S	A	L	I	R	A	M	A	L	E			
G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R		
A	R	E	S	A	O					E	N	E
Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T		
I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S		

*Thënie të mençura*

- Mos trokit në derën e dikujt që e hap atë për të gjithë ... sepse miku i të gjithëve nuk është miku i askujt !!!
- Ai që tradhton besimin tim, nuk vlen as respektin tim !!!
- Thonë se të gjithë njerëzit janë si nëna, kanë një anë të cilën kurrë nuk ia tregojnë askujt !!!
- Gabimi më i madh në jetë është të lejosh diçka njerëz të qëndrojnë në jetën tuaj më shumë se sa e meritojnë!!!

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR**

R	M	R	E	S	F	D	E	T	I			
M	A	M	A	M	M	E	P	K	E	L		
A	M	I	S	I	M	O	N	I	A	B	O	
T	O	T	R	E	T	O	R	I	K	A		
E	N	O	K	D	O	M	A	T	E	L		
R	M	A	R	T	I	R	E	T	O			
I	A	R	A	T	O	N	E	R	R			
A	N	M	Q	I	L	A	R	R	O	D		
L	E	N	T	E	V	E	A	P	L	E	R	
A	R	M	A	N	I	A	N	D	E			
T	E	R	R	I	T	O	R	I	A	L	E	M
K	L	A	S	A	S	P	A	R	T	A	K	U
K	A	R	R	I	E	R	A	R	T			
M	E	R	C	E	N	A	R	R	O			
G	J	A	H	U	N	I	N	J	A			
J	I	T	U	G	S	U	M	O				
L	E	E	E	T	O	P	L	E	A	R		
F	T	A	S	M	S	B	R	O	T	A		
R	M	R	S	M	O	T	E	R	O			
O	B	E	R	O	N	M	I	T	A			
N	T	I	N	A	T	E	H	A	U			
T	A	S	T	I	R	O	I	D	E	T		
I	N	T	E	R	I	M	K	E	N			

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

